



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 123

Tiranë – E premte, 16 shtator 2022

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 587, datë 7.9.2022	Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Ndërtimi i hidrocentralit ‘Grabova 2’ mbi pellgun ujëmbledhës të përroit të Grabovës, degë e lumit të Devollit, në qarkun Elbasan”..... 15915
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 594, datë 7.9.2022	Për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, për zbatimin e projektit “Element II” 15917
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 597, datë 14.9.2022	Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, dhe shkëmbimin e pronës, në funksion të procesit të rindërtimit në zonën e planifikuar për rindërtim, sipas planit të detyruar vendor për zonën e dëmtuar pikësore për 5 banesa kolektive, në Bashkinë Durrës..... 15922
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 600, datë 14.9.2022	Për trajtimin dhe mbulimin e shpenzimeve financiare të personelit ushtarak dhe civil të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, gjatë kohës që emërohen me detyrë jashtë vendit..... 15926
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 601, datë 14.9.2022	Për miratimin e listës së vendeve të treta, si shtete të treta të sigurta. 15929
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 602, datë 14.9.2022	Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore..... 15930
Udhëzim i ministrit të Brendshëm nr. 174, datë 12.9. 2022	Mbi procedurat e trajtimit të të huajve me qëndrim të parregullt në territorin e Republikës së Shqipërisë..... 15934
Urdhër i drejtorit të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar nr. 281, datë 13.9.2022	Për delegim të përkohshëm të kompetencave..... 15957

Vendim i Mbledhjes së Posaçme të Gjyqtarëve nr. 3, datë 12.9.2022	Për zgjedhjen e z. Ilir Toska, anëtar të Gjykatës Kushtetuese.....	15957
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 389/6, datë 14.9.2022	Për shpronësim për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Mbikalim këmbësorësh Bahçallëk”.....	15959
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Mentor Bardhi.....	15959



VENDIM
Nr. 587, datë 7.9.2022

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES
PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA PROJEKTI
“NDËRTIMI I HIDROCENTRALIT
‘GRABOVA 2’ MBI PELLGUN
UJËMBLEDHËS TË PËRROIT TË
GRABOVËS, DEGË E LUMIT TË
DEVOLLIT, NË QARKUN ELBASAN”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Ndërtimi i hidrocentralit ‘Grabova 2’ mbi pellgun ujëmbledhës të përroit të Grabovës, degë e lumit të Devollit, në qarkun Elbasan”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të shoqërisë koncesionare “HK HEC Grabova 2” sh.p.k.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit “tokë arë”, me një vlerë të përgjithshme prej 355 395 (treqind e pesëdhjetë e pesë mijë e treqind e nëntëdhjetë e pesë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 355 395 (treqind e pesëdhjetë e pesë mijë e treqind e nëntëdhjetë e pesë) lekësh, përballohet nga shoqëria koncesionare “HK HEC Grabova 2” sh.p.k.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga shoqëria koncesionare “HK HEC Grabova 2” sh.p.k.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë shoqërisë koncesionare “HK HEC Grabova 2” sh.p.k.

8. Shoqëria koncesionare “HK HEC Grabova 2” sh.p.k. kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara në kontratën e koncesionit.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore Gramsh, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me shoqërinë koncesionare “HK HEC Grabova 2” sh.p.k., nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit, përfaqësuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore Gramsh, pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit, përfaqësuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, shoqëria koncesionare “HK HEC Grabova 2” sh.p.k., Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore Gramsh, si dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Elbasan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI “NDËRTIMI I HIDROCENTRALIT ‘GRABOVA 2’ MBI PELLGUN UJËMBLEDHËS TË PËRROIT TË GRABOVËS, DEGË E LUMIT TË DEVOLLIT, NË QARKUN ELBASAN”

Nr.	Pronari			Të dhënat (mbi pasurinë sipas ASHK-së)						Vlerësimet për shpronësim sipas llojit të pasurisë			Vlera totale (lekë)	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr. i	Vol.	Faqe	Lloji i pas.	Sip. totale (m ²)	Shpronësim tokë “arë”				
					pas.					Sip. (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera (lekë)		
Prona në zonën kadastrale z.k. 1830, fshati Grabovë - Sipër														
1	Mihal	Ilia	Çyço	1831	155	1	129	Arë	600	185	174	32190	32,190	Konfirmuar nga ASHK-ja
2	Sotirag	Zoi	Çyço	1831	152	1	139	Arë	700	150	174	26100	26,100	Konfirmuar nga ASHK-ja
3	Vasil	Bani	Çyço	1831	153	1	152	Arë	1650	300	174	52200	52,200	Konfirmuar nga ASHK-ja
4	Sokrat	Tefi	Paço	1831	148	1	210	Arë	3600	90	174	15660	15,660	Konfirmuar nga ASHK-ja
Prona në zonën kadastrale 2413, fshati Lenia														
5	Nazmi	Faslli	Ceci	2413	44	3	22	Arë	2150	195	174	33930	33,930	Konfirmuar nga ASHK-ja
6	Qerim	Ibrahim	Ibro	2413	275	3	14	Arë	400	160	174	27840	27,840	Konfirmuar nga ASHK-ja
7	Mitat	Adem	Meçi	2413	35	3	62	Arë	3500	600	174	104400	104,400	Konfirmuar nga ASHK-ja
8	Bardhyl	Haki	Ibra	2413	278	4	9	Arë	950	12.5	174	2175	2,175	Sekuestro konservative
	Petrit	Haki	Ibro							12.5	174	2175	2,175	Sekuestro konservative
	Fëllëzë	Haki	Matraku							12.5	174	2175	2,175	Sekuestro konservative
	Kalem	Haki	Ibro							12.5	174	2175	2,175	Sekuestro konservative
	Myzejena	Haki	Mollosmani							12.5	174	2175	2,175	Sekuestro konservative
	Fatmir	Haki	Ibra							12.5	174	2175	2,175	Sekuestro konservative
	Lavderim	Haki	Ibra							12.5	174	2175	2,175	Sekuestro konservative
	Kristina	Haki	Ibro							12.5	174	2175	2,175	Sekuestro konservative
9	Nevrus	Abedin	Meçi	2413	348	2	68	Arë	800	122	174	21228	21,228	Konfirmuar nga ASHK-ja
10	Hajdar	Abedin	Meçi	2413	343	2	57	Arë	550	50	174	8700	8,700	Konfirmuar nga ASHK-ja
11	Ramazan	Sejat	Ibro	2413	281	2	191	Arë	2300	90.5	174	15747	15,747	Konfirmuar nga ASHK-ja
Vlera totale													355,395	

Shënime.

1. Për tokën “arë” çmimi i llogaritur është marrë nga vendimi nr. 89, datë 3.2.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.



VENDIM
Nr. 594, datë 7.9.2022

**PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMIT
TË MIRËKUPTIMIT NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
FONDACIONIT SHQIPTARO-
AMERIKAN PËR ZHVILLIM,
PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT
“ELEMENT IT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 39, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF), për zbatimin e projektit “Element IT”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**MEMORANDUM MIRËKUPTIMI
NDËRMJET FONDACIONIT SHQIPTARO-
AMERIKAN PËR ZHVILLIM
DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRI I SHTETIT
PËR RININË DHE FËMIJËT,
PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT
“ELEMENT IT”**

24.8.2022

Ky Memorandum Mirëkuptimi (“Memorandum”) lidhet ndërmjet:

Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (Albanian-American Development

Foundation), një organizatë jofitimprurëse e organizuar dhe e themeluar sipas ligjeve të Shtetit të *Delaware-it*, me seli në 780 Third Ave, kati 46, New York, NY 10017, SHBA, që vepron me anë të degës së saj në Shqipëri, të regjistruar me vendimin nr. 359, datë 18.3.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me zyrë të regjistruar në adresën: Rruga “Ibrahim Rugova”, ndërtesa 42, hyrja 7, apartamenti 60, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar rregullisht nga z. Martin Mata dhe z. Aleksandër Sarapuli, drejtorë ekzekutivë të përbashkët (në vijim referuar si “AADF”),

dhe

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, me seli në adresën: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, Shqipëri, i përfaqësuar në këtë Memorandum nga Znj. Bora Muzhaqi, në cilësinë e ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe nënshkrues i autorizuar (në vijim referuar si “Këshilli i Ministrave”),

individualisht referuar në këtë Memorandum si “Pala”, dhe bashkërisht si “Palët”, MEQENËSE:

A. Përgjatë dy dekadave të fundit, qeveritë dhe mësuesit në mbarë botën kanë njohur premisat e jashtëzakonshme të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK);

B. Bordi i drejtorive të AADF-së ka miratuar projektin “Element IT”, për përfshirjen e lëndës TIK në planin mësimor të shkollave fillore publike, për klasat I, II dhe III (“Projekti”);

C. Me anë të këtij Projekti, AADF-ja synon fillimisht të testojë dhe më pas të zgjerojë përfshirjen e lëndës TIK në të gjitha shkollat e arsimit bazë publik në Shqipëri;

D. Palët ndajnë të njëjtin këndvështrim për rëndësinë e rritjes së cilësisë së edukimit në teknologji që në arsimin fillor;

E. Këshilli i Ministrave dhe AADF-ja dëshirojnë të bashkëpunojnë për realizimin e Projektit, sipas kompetencave dhe fushave përkatëse të përgjegjësisë.

Për sa më sipër, duke marrë parasysh angazhimet e deritanishme, Palët lidhin këtë Memorandum për të zyrtarizuar marrëdhënien e tyre bashkëpunuese, sipas kushteve të mëposhtme:

1. QËLLIMI

1.1 Ky Memorandum ka si synim konfirmimin e angazhimit të përbashkët dhe ndërtimin e një marrëdhënie bashkërenduese dhe bashkëpunuese mes Palëve për përfshirjen e lëndës së teknologjisë



së informacionit dhe të komunikimit në planin mësimor të arsimit bazë në Shqipëri, nga klasa e parë deri në klasën e tretë, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në këtë dokument.

1.2 Palët bien dakord të kontribuojnë dhe angazhohen për përmbushjen e qëllimit të këtij Memorandumi, sipas kompetencave dhe fushave përkatëse të përgjegjësisë.

2. PËRSHKRIM I SHKURTËR I PROJEKTT

2.1 Projekti është hartuar dhe miratuar nga AADF-ja për një periudhë 5-vjeçare dhe do të zbatohet në bashkëpunim me palëve. Ai synon zbatimin e lëndës së teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit në shkollat e arsimit bazë, në përputhje me planin mësimor të arsimit bazë në Shqipëri, të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit që parashikon përfshirjen e lëndës së TIK-ut në lëndët me zgjedhje të klasave I–III.

2.2 Projekti do të zbatohet në këto faza:

2.2.1 Viti I – Zbatimi i kurrikulës TIK në klasat e para, në të paktën 100 shkolla të arsimit bazë publik të vendit të pajisura me laborator të teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit të quajtur Laborator Smart (në vijim **“Laborator Smart”**);

2.2.2 Viti II – Shtrirja e zbatimit të kurrikulës TIK në klasat e para, në të gjitha shkollat e arsimit bazë publik të vendit të pajisura me Laborator Smart. Hartimi, miratimi dhe zbatimi i kurrikulës së TIK-ut në klasat e dyta, në të paktën 100 shkolla të arsimit bazë publik të vendit;

2.2.3 Viti III – Shtrirja e zbatimit të kurrikulës së TIK-ut në klasat e dyta, në të gjitha shkollat e arsimit bazë, publike, të pajisura me Laborator Smart. Hartimi, miratimi dhe zbatimi i kurrikulës së TIK në klasat e treta në të paktën 100 shkolla të arsimit bazë publik të vendit;

2.2.4 Viti IV – Shtrirja e zbatimit të kurrikulës së TIK-ut në klasat e treta, në të gjitha shkollat e arsimit bazë, publike, të vendit të pajisura me Laborator Smart;

2.2.5 Viti V – Vlerësimi i zbatimit dhe i ndikimit të Projektit.

2.3 Objektivat e përgjithshëm të Projektit janë:

2.3.1 Përfshirja e kurrikulës TIK në planin mësimor për klasat I, II dhe III, dhe shtrirja e zbatimit të saj në të gjitha shkollat e arsimit bazë publik në Shqipëri;

2.3.2 Ofrimi i një platforme plotësuese *online* për të mbështetur mësimdhënien dhe të mësuarit e kodimit dhe të të menduarit kompjuterik në të gjitha shkollat e arsimit bazë publik në Shqipëri;

2.3.3 Trajnimi i mësuesve për zhvillimin e lëndës së re TIK.

3. PËRGJEGJËSITË E PALËVE

3.1 Angazhimet e përbashkëta të Palëve përfshijnë, por nuk kufizohen, në sa më poshtë:

3.1.1 Palët do të angazhohen për zbatimin e fazës së parë (viti I) të Projektit në 100 shkollat e arsimit bazë publik të përzgjedhura për vitin shkollor 2022–2023, duke zgjeruar zbatimin e tij në të gjitha shkollat e arsimit bazë në Shqipëri përgjatë vitit të dytë deri në vitin e katërt të Projektit, sipas fazave të tij të parashikuara në nenin 2 të Memorandumit;

3.1.2 Palët do të kontribuojnë dhe ofrojnë njohuritë (*know-how*), ekspertizën dhe pronësinë intelektuale për realizimin e qëllimit të këtij Memorandumi;

3.1.3 Palët do të informojnë dhe konsultohen me njëri-tjetrin, në mënyrë të rregullt, për çështjet me interes të përbashkët;

3.1.4 Secila Palë do të caktojë nga një pikë kontakti për çdo çështje që lidhet me zbatimin dhe mbarëvajtjen e këtij Memorandumi;

3.2 Për qëllim të këtij Memorandumi, AADF-ja do të:

3.2.1 Financojë dhe administrojë fondet e veta, për:

3.2.1.1 Identifikimin dhe kontraktimin e ekspertizës kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas procedurave të veta, për hartimin e kurrikulës TIK për klasat I, II dhe III të shkollave të arsimit bazë publik;

3.2.1.2 Ofrimin e trajnimit të mësuesve të lëndës TIK, të përfshirë në Projekt, sipas fazave të zbatimit të tij, pa përfshirë kostot e transportit apo të akomodimit të mësuesve pjesëmarrës në trajnim;

3.2.1.3 Blerjen e 1,600 pajisjeve kompjuterike, sipas procedurave të veta, për 100 laboratorët Smart, që do të ndërtohen nga qeveria shqiptare në 100 shkollat e përzgjedhura për fazën e parë të Projektit;

3.2.1.4 Vënien në dispozicion dhe përdorimin e platformës për mësimin e kodimit në klasat I, II dhe III për 4 vitet e para të Projektit, sipas planit të dakordësuar të shtrirjes së tij në shkollat e arsimit bazë;



3.2.2 Mbikëqyrë zbatimin e Projektit dhe do të vlerësojë ndikimin e tij pas 4 viteve të para të implementimit të Projektit.

3.3 Për qëllim të këtij Memorandumi, Këshilli i Ministrave do të:

3.3.1 ngrëjë një grup ndërinstitucional pune me përbërje nga ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët (MSHRF), Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS), Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP), Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) për koordinimin e institucioneve shtetërore dhe bashkërendimin e punëve për realizimin e të këtij Memorandumi, ku AADF-ja do të ftohet në çdo rast të marrë pjesë nëpërmjet përfaqësuesve të saj.

3.3.2 identifikojë dhe dakordësojë me AADF-në 100 shkollat e arsimit bazë publik ku do zbatohet Projekti për vitin e parë dhe të realizojë, me fondet e buxhetit të shtetit, ngritjen e 100 laboratorëve Smart, nga një laborator në secilën shkollë të rënë dakord, duke i pajisur ato me mjetet e nevojshme, përfshirë rrjetin kompjuterik, elektrik, ekran interaktiv, mikrokompjuterat të programueshëm, bazuar në standardet teknike të përgatitura nga AKSHI, përpara fillimit të vitit shkollor 2022–2023;

3.3.3 ngrëjë, me fondet e veta, laboratorët SMART në të gjitha shkollat e arsimit bazë publik ku do të shtrihet zbatimi i kurrikulës TIK dhe t'i pajisë ato me mjetet e nevojshme, përfshirë rrjetin kompjuterik, elektrik, pajisje kompjuterike, ekran interaktiv, mikrokompjuterat të programueshëm, bazuar në standardet teknike të përgatitura nga AKSHI, për shtrirjen e zbatimit të Projektit në të gjitha shkollat fillore të vendit në vitin II të Projektit e në vijim;

3.3.4 ofrojë mbështetjen institucionale të nevojshme dhe të bashkëpunojë gjatë gjithë fazave të hartimit të kurrikulës TIK nga ekspertët kombëtarë dhe ndërkombëtarë të kontraktuar nga AADF-ja, ndër të tjera, duke vënë në dispozicion dokumentacionin dhe të dhënat e disponueshme që mund të nevojiten gjatë këtij procesi, si dhe do të ndjekë të gjitha procedurat ligjore dhe miratojë aktet e nevojshme për miratimin dhe përfshirjen e kësaj kurrikule në shkollat e arsimit bazë publik;

3.3.5 identifikojë, në bashkëpunim me AADF-në, listën e mësuesve të lëndës në klasat ku do të

zbatohet kurrikula TIK, të cilët do të trajnohen për zhvillimin e lëndës TIK dhe të sigurojë angazhimin e tyre për t'u trajnuar sipas fazave të zbatimit të Projektit;

3.3.6 ofrojë mbështetje logjistike për realizimin e trajnimit të mësuesve, që do të përfshihen në Projekt me fonde të AADF-së, duke përfshirë vënien në dispozicion pa kundërshtpërblim të ambienteve të përshtatshme për realizimin e trajnimeve;

3.3.7 bashkëpunojë me AADF-në për të rishikuar të gjithë kurrikulën TIK në të gjitha klasat e sistemit parauniversitar për të siguruar koherencën ndër klasa, si dhe përditësimin e saj;

3.3.8 sigurojë nënshkrimin përmes Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të marrëveshjes përkatëse të licencës për përdorimin e platformës për mësimin e kodimit, që do të financohet nga AADF-ja;

3.3.9 mbulojë me fondet e veta, të gjitha kostot e zbatueshme për përdorimin e platformës për mësimin e kodimit pas vitit të katërt të Projektit e në vijim dhe të vlerësojë mundësinë e përdorimit të një platforme për mësimin e kurrikulës TIK edhe për klasat IV–XII;

3.3.10 të caktojë institucionin qendror përgjegjës për marrjen në dorëzim të pajisjeve kompjuterike që do të blihen nga AADF-ja, të sigurojë shpërndarjen e këtyre pajisjeve në shkollat e përzgjedhura dhe të pajisura me laborator Smart dhe të marrë të gjitha masat e arsyeshme për ruajtjen e këtyre pajisjeve, si dhe për t'i zëvendësuar ato në rast humbjeje ose dëmtimi, për të garantuar zbatimin efikas të Projektit, përgjatë kohëzgjatjes së tij.

4. PRONËSIA INTELEKTUALE

4.1 Palët bien dakord dhe pranojnë se çdo produkt apo krijimtari që rezulton nga veprimtaria e AADF-së, në lidhje me këtë Projekt, përfshirë të drejtat e pronësisë intelektuale të lidhura me të, janë pronë e vetme e AADF-së. AADF-ja i jep të drejtën joekskluzive dhe pa kundërshtpërblim Këshillit të Ministrave, për të përdorur kurrikulën TIK të hartuar nga ekspertët kombëtarë dhe ndërkombëtarë të kontraktuar nga AADF-ja, gjatë kohëzgjatjes së këtij memorandumi, për qëllim të zbatimit të Projektit.

4.2 Pa paragjykuar sa më sipër, palët bien dakord dhe pranojnë se AADF-ja nuk mban përgjegjësi për origjinalitetin dhe/ose cilësinë e kurrikulës TIK, që do të hartohet nga ekspertët



kombëtarë dhe ndërkombëtarë të kontraktuar nga AADF-ja, por kjo e fundit angazhohet të sigurojë nga ekspertët, deklaratë mbi origjinalitetin dhe/ose cilësinë e kurrikulës TIK të hartuar.

4.3 Këshilli i Ministrave deklaron dhe garanton se nuk do të cenojë apo shkelë të drejtat e pronësisë intelektuale të AADF-së dhe palëve të treta të kontraktuara nga AADF-ja, për qëllim të zbatimit të këtij Projekti, dhe angazhohet të njoftojë AADF-në menjëherë, në rast se vihet në dijeni të ndonjë shkeljeje. Përveç autorizimit me shkrim nga AADF-ja, Këshilli i Ministrave nuk do të përdorë ose kopjojë materiale apo informacione në pronësi të AADF-së, përfshirë materiale të mbrojtura nga e drejta e autorit, sekrete tregtare, logo, marka tregtare, emra *domain*, *software*, llogari në medie sociale apo çdo pronë tjetër intelektuale të kësaj të fundit. Ky detyrim i Këshillit të Ministrave do të mbetet në fuqi pa kufizim kohor pas përfundimit apo zgjidhjes së këtij Memorandumi.

5. DEKLARIMET PUBLIKE

5.1 Për qëllim të këtij Memorandumi, **“Deklaratë publike”** do të thotë çdo shpërndarje informacioni te publiku, në lidhje me Projektin, nëpërmjet komunikatave për shtyp, çdo prodhim audiovizual dhe të shkruar në formën e intervistave, dokumentarëve, emisioneve, deklaratave ose daljeve publike, përfaqësuesve, personave të autorizuar ose punonjësve të saj, në medie, rrjete sociale dhe çdo formë tjetër komunikimi publik.

5.2 Secila Palë do të njohë dhe përmendë në çdo deklaratë publike kontributin e Palës tjetër në lidhje me zbatimin e Projektit. Palët do të informojnë dhe konsultohen paraprakisht me njëra-tjetrën për çdo Deklaratë Publike, në lidhje me Projektin. Këshilli i Ministrave mund të lëshojë komunikata shtypi, kryejë Deklaratë Publike ose komunikojë me medien, në lidhje me Projektin, pas miratimit paraprak të AADF-së. AADF-ja nuk do të vonojë ose refuzojë në mënyrë të paarsyeshme dhënien e miratimit, sipas këtij neni për informimin e publikut nga Këshilli i Ministrave në përmbushje të detyrimeve të tij ligjore.

5.3 Palët do të njohin dhe përmendin në gjuhë të përshtatshme në të gjitha Deklaratat Publike, burimin e fondeve të përdorura për Projektin nëpërmjet kontributit të AADF-së, si fonde të Qeverisë Amerikane, të cilat kanë për qëllim të jenë dhurim i popullit amerikan për qytetarët shqiptarë,

për të ndërtuar dhe përforcuar më tej miqësinë që ekziston ndërmjet dy vendeve. Kjo gjuhë do të përsihet në të gjithë informacionin që ndahet me publikun, duke përfshirë por pa u kufizuar në të gjitha deklaratat, në lidhje me Projektin ose aktivitete të tjera, broshura, faqe interneti, publikime ose informacion të ngjashëm që ofrohet ose shpërndahet nga/ose nëpërmjet secilës Palë.

5.4 Palët do të bashkëpunojnë në zhvillimin e materialeve promovuese, në lidhje me Projektin. Logot e AADF-së dhe të Këshillit të Ministrave do të jenë të dukshme dhe do të vendosen në mënyrë të qartë gjatë aktiviteteve të Projektit dhe fushatave publike, në çdo material promovues, banera, postera, komunikata për shtyp, fletushka dhe çdo lloj tjetër materiali publicitar, deklaratë publike apo publikime që do të bëhen në bazë të këtij Projekti. Logoja e AADF-së do të jetë në përmasa dhe dominim ekuivalent me logot e tjera, të tilla si Këshilli i Ministrave apo institucione të tjera shtetërore.

6. KONFIDENCIALITETI DHE MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

6.1 Secila nga Palët e këtij Memorandumi merr përsipër të mos bëjë të ditur, përhapë ose komunikojë informacione në lidhje me veprimtarinë e Palës tjetër, kushtet dhe ekzistencën e këtij Memorandumi, që në atë kohë nuk janë të njohura nga publiku (**“Informacioni Konfidencial”**). Gjithashtu, secila Palë merr përsipër të mos përdorë Informacionin Konfidencial për qëllime të tjera përveç qëllimit të këtij Memorandumi.

6.2 Palët angazhohen të ruajnë të dhënat sensitive, personale dhe privatësinë e informacionit që mund të vihen në dijeni gjatë bashkëpunimit dhe zbatimit të këtij Memorandumi dhe t'i trajtojnë këto të dhëna në përputhje me legjislacionin në fuqi.

6.3 Ky detyrim i ndërsjellë i Palëve për konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale do të mbetet në fuqi pa kufizim kohor pas përfundimit apo zgjidhjes së këtij Memorandumi.

7. KOMUNIKIMI DHE KOORDINIMI NDËRMJET PALËVE

Palët angazhohen të mbajnë komunikim të vazhdueshëm ndërmjet tyre dhe të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e detyrimeve në kuadër të këtij Memorandumi. Si



rregull, komunikimi kryhet në formë shkresore, por edhe në formatin e komunikimit elektronik.

8. DEKLARIMET E GARANCISË

Në këtë datë, Palët deklarojnë dhe garantojnë sa më poshtë:

8.1 Ato kanë kompetencat dhe autoritetin e plotë për të lidhur këtë Memorandum;

8.2 Ato kanë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për autorizimin e lidhjes së këtij Memorandumi dhe për përmbushjen e angazhimeve të tyre sipas këtij Memorandumi.

9. PRONËSIA E INVESTIMIT TË AADF-së

9.1 Para fillimit të vitit shkollor 2022–2023, AADF-ja do t'i dorëzojë Këshillit të Ministrave pajisjet kompjuterike dhe Këshilli i Ministrave, nëpërmjet institucioneve të saj përkatëse, do t'i shpërndajë ato në shkollat e përzgjedhura me laborator TIK.

9.2 Të gjitha pajisjet kompjuterike të investuar nga AADF-ja, sipas këtij Memorandumi, do t'i dhurohen institucionit të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave dhe do të kalojnë në pronësi të këtij institucioni me pranimin e dhurimit dhe marrjen e tyre në dorëzim.

10. KOHËZGJATJA DHE ZGJIDHJA

10.1 Ky Memorandum hyn në fuqi në datën kur AADF-ja merr njoftim me shkrim nga Këshilli i Ministrave për përfundimin e procedurave të brendshme të miratimit nga ky i fundit dhe është i vlefshëm deri në datën zyrtare të përfundimit të Projektit, përveçse kur zgjidhet paraprakisht nga njëra prej Palëve, sipas parashikimeve të mëposhtme të këtij neni.

10.2 Ky Memorandum mund të zgjidhet para përfundimit të afatit të mësipërm nga secila Palë nëpërmjet një njoftimi paraprak me shkrim drejtuar Palëve të tjera të paktën 1 (një) muaj, afat ky me kalimin e të cilit Memorandumi quhet i zgjidhur për atë Palë. Palët e tjera mund të vendosin të vijnë bashkëpunimin e tyre për zbatimin e Projektit, nëse diçka e tillë është e mundur.

10.3 Secilës Palë i lind e drejta që në çdo kohë ta zgjidhë këtë Memorandum me efekt të menjëhershëm, me një njoftim me shkrim drejtuar Palës tjetër, nëse kjo e fundit nuk përmbush detyrimet e caktuara në këtë Memorandum, edhe nëse kjo nuk është e mundur, të provohet me prova shkresore.

11. LIGJI RREGULLUES DHE JURIDIKSIONI

11.1 Ky Memorandum do të rregullohet nga dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

11.2 Palët bien dakord të bashkëpunojnë në mirëbesim në përmbushjen e kushteve dhe të afateve të këtij Memorandumi. Vështirësitë e paparashikuara, mosmarrëveshjet ose mospajtimet që rezultojnë nga zbatimi i këtij Memorandumi do të zgjidhen me mirëkuptim, nëpërmjet bisedave dhe negociatave midis Palëve.

11.3 Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin nga interpretimi, vlefshmëria, zbatimi, zgjidhja ose në lidhje me shkeljen e ndonjë kushti të këtij Memorandumi, të cilat nuk janë mundur të zgjidhen miqësisht, do t'i referohen Qendrës Shqiptare për Ndërmjetësim dhe Arbitrazh Tregtar (MEDART), Tiranë, Shqipëri. Mosmarrëveshja do të gjykohej nga një gjykatës i vetëm, i cili do të emërohet nga drejtori i përgjithshëm i MEDART-it, brenda 7 ditëve nga data kur MEDART-i është njoftuar për kërkesën e arbitrazhit.

11.4 Rregullat procedurale që duhet të zbatohen janë ato të përcaktuara nga MEDART-i dhe gjuha e arbitrazhit është gjuha shqipe. Vendimi i gjykatësit do të jetë përfundimtar dhe ligjërues i detyrueshëm dhe i zbatueshëm për Palët.

12. KUFIZIMI I PËRGJEGJËSISË

AADF-ja gëzon imunitetin dhe të drejtat e siguruar nga Marrëveshja Bilaterale Ekonomike e nënshkruar midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA) datë 10 qershor 1992, ratifikuar me dekretin e Presidentit të Republikës nr. 224 datë 11.6.1992.

13. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

13.1 Ky Memorandum përbën mirëkuptimin në tërësi të Palëve dhe asnjë kusht, afat, mirëkuptim ose marrëveshje, që synon të ndryshojë kushtet e këtij Memorandumi nuk do të jetë detyrues, përveçse nëse bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga të gjitha Palët.

13.2 Realizimi i aktiviteteve të përbashkëta mund të rregullohet me marrëveshje ose kontrata të veçanta, duke bërë përpjekjet më të mira për përmbushjen nga të gjitha Palët. Palët mund të bien dakord për këto marrëveshje shtesë, në rast se mund ta gjykojnë të përshtatshme nga pikëpamja e eksperiencës, për të përmirësuar ose zhvilluar një



aspekt të caktuar të bashkëpunimit të tyre sipas këtij Memorandumi.

13.3 Gjuha e këtij Memorandumi dhe gjuha për komunikimet, sipas këtij Memorandumi do të jetë gjuha shqipe.

13.4 Ky Memorandum është detyrues për Palët, pasardhësit e tyre dhe përfituesit e të drejtave të tyre përkatëse.

13.5 Ky Memorandum është nënshkruar në 2 (dy) kopje origjinale, në gjuhën shqipe, me të njëjtën vlerë secila.

FONDACIONI SHQIPTARO-
AMERIKAN PËR ZHVILLIM

KËSHILLI I
MINISTRAVE

Z. Martin Mata
Drejtor ekzekutiv

**Z. Aleksandër
Sarapuli**
Drejtor ekzekutiv

Znj. Bora Muzhaqi
Ministër i Shtetit për
Rininë dhe Fëmijët

Datë 24.8.2022

Datë 24.8.2022

VENDIM

Nr. 597, datë 14.9.2022

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, DHE SHKËMBIMIN E PRONËS, NË FUNKSION TË PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË ZONËN E PLANIFIKUAR PËR RINDËRTIM, SIPAS PLANIT TË DETYRUAR VENDOR PËR ZONËN E DËMTUAR PIKËSORE PËR 5 BANESA KOLEKTIVE, NË BASHKINË DURRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar; të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, dhe në vijim të vendimit nr. 7, datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për kushtet dhe procedurat për shpronësimet dhe/ose shkëmbimin e pronës, për interes publik, në funksion të procesit të rindërtimit”, të ndryshuar; e të vendimit nr. 8, datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të përfitimit të sipërfaqeve ndërtimore në objektet e reja për banim nga subjektet që

posedojnë ndërtime të klasifikuara si ndërtime pa leje”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendës-kryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, dhe shkëmbimin e pronës, në funksion të procesit të rindërtimit në zonën e planifikuar për rindërtim, sipas planit të detyruar vendor për zonën e dëmtuar pikësore, për 5 banesa kolektive, në Bashkinë Durrës, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi dhe shkëmbimi i pronës bëhen në favor të Bashkisë Durrës.

3. Shkëmbimi i pasurive të paluajtshme, pronë private, për të cilat pronarët kanë pranuar kompensimin me shkëmbim për pasuritë e llojit “ndërtesë banimi” dhe “ndërtesë jobanimi” me një pasuri të ardhshme në pronësi të shtetit, bëhet referuar legjislacionit në fuqi, sipas cilësimeve në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, si dhe marrëveshjeve/kontratave paraprake që janë lidhur/lidhen, ndërmjet Bashkisë Durrës dhe qytetarëve që shprehin dakordësinë, brenda periudhës së zbatimit të projektit.

4. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “trull”, “ndërtesë banimi” dhe “ndërtesë jobanimi”, në vlerën 7 270 855 (shtatë milionë e dyqind e shtatëdhjetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë.

5. Vlera e përgjithshme e kompensimit prej 7 270 855 (shtatë milionë e dyqind e shtatëdhjetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë përballohet nga shpenzimet e fondit të rindërtimit dhe i transferohet Bashkisë Durrës, në buxhetin e vitit 2022, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

6. Pronarët e pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur certifikatën e pronësisë origjinale ose dublikatë, kartelën e pasurisë të rifreskuar, si dhe hartën treguese të regjistrimit, pranë Bashkisë Durrës, referuar aktmarrëveshjes së lidhur.



7. Shpronësimi fillon menjëherë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

8. Bashkia Durrës kryen likuidimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të shpronësuar, dhe bën shkëmbimin e pronës, referuar aktmarrëveshjeve të lidhura.

9. Afati i kryerjes së shpronësimit në vlerë monetare do të jetë momenti i fillimit të realizimit të projektit. Afati i kryerjes së shkëmbimit të pronës private me një pronë shtetërore të ardhshme, sipas marrëveshjeve të nënshkuara, do të jetë në përfundim të realizimit të rindërtimit në zonën e planifikuar për rindërtim, sipas planit të detyruar vendor për zonën e dëmtuar pikësore, për 5 banesa kolektive, në Bashkinë Durrës.

10. Bashkia Durrës i kërkon Agjencisë Shtetërore të Kadastrës që brenda 30 (tridhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e vendimit të shpronësimit dhe të shkëmbimit ose nga data që ka marrë formë të prerë vendimi i gjykatës, në rast se kompensimi kryhet nëpërmjet shkëmbimit të pronës private me një pasuri shtetërore të ardhshme, në kartelën e pasurisë për pronën truall, ku do të krijohet pasuria e ardhshme, regjistruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, të bëjë regjistrimin e barrës ligjore, sipas legjislacionit në fuqi, në favor të pronarit privat, për përfitimin në të ardhmen të pasurisë shtetërore, kur kjo e fundit të regjistrohet në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës. Kur pronari/pronarët privat/privatë ka/kanë pranuar kushtet e shkëmbimit, pjesë të kërkesës për regjistrim janë dhe marrëveshjet përkatëse. Me regjistrimin e pasurisë së ardhshme në regjistrin përkatës pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, me kërkesë të njësisë zbatuese dhe të përfaqësuesit të pronarit shtet bëhet regjistrimi i kalimit të të drejtave të pronësisë për pronën shtet, në favor të pronarit privat.

11. Bashkia Durrës brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave për shpronësimin, i kërkon Agjencisë Shtetërore të Kadastrës të kryejë regjistrimin e pasurive, pronë private, të shpronësuar, sipas legjislacionit në fuqi dhe referuar aktmarrëveshjes së lidhur.

12. Gjatë periudhës së zbatimit të projektit, (përfundimin e punimeve) qytetarët, nëse nuk kanë në pronësi ose në posedim objekte të tjera banimi, do të strehohen nga njësia e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet programeve të rindërtimit, të parashikuara në aktin normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, ose në legjislacionin në fuqi për strehimin social.

13. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar, deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale dhe regjistrimi i kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Durrës për pasuritë e shpronësuar.

14. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

15. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Bashkia Durrës dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku



LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA PROCESI I RINDERTIMIT NË ZONËN E RE PËR ZHVILLIM, SIPAS PLANIT TË DETYRUAR VENDOR, PËR ZONËN E DËMTUAR PIKËSORE, PËR 5 BANESA KOLEKTIVE NË BASHKINË DURRËS

Nr.	TE DHËNA MË STATUTIN JURIDIK TË PAGRISË												VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM SIPAS LLOIT TË PAGRISË																	Vlera totale e shpronësuar	KOMENTE					
	C. SAKSIONI I PAGRISË			A. SAKSIONI I IDENTIFIKIMIT TË PAGRISË						B. SAKSIONI I PËRSHKRIMIT TË PAGRISË				Përshkrim i veçorë	SEKSION I D	SEKSION I E	Shpronësimi total "tutës"					Niveli i sacit (shp)					Niveli i sacit (shp)							Përfundim i procedurës në rast se nuk ka shpronësuar		
	Emri	Adresa	Mësimi	ZK	Nr. i pajisjes	Vat.	Faq. n	Indeksi i sacit	Dokumenti i pronësisë	Llogji i pajisjes	Sip. tote (m²)	Sipërfaqja e përdorimit (m²)	Sip. tote për shpronësimin (m²)				Cena tote për shpronësimin (m²)	Vlera (miliardë)	Sip. tote (m²)	Sip. tote për shpronësimin (m²)	Cena tote për shpronësimin (m²)	Vlera (miliardë)	Sip. tote (m²)	Sip. tote për shpronësimin (m²)	Cena tote për shpronësimin (m²)	Vlera (miliardë)	Sip. tote (m²)	Sip. tote për shpronësimin (m²)	Cena tote për shpronësimin (m²)			Vlera (miliardë)				
1. PAGRISË PRIVATE																																				
1	VOLETA	RAMEZ	BARALLI	0513	5672	KUB BEKIROVIT									6,539.62	214	214	214		14,712,300	218	0	218	218		5,319.48	2	25,032,212	7,270,855							
															1,132.10					6,115,700																
1	VOLETA	RAMEZ	BARALLI	0513	5672	KUB BEKIROVIT									6,539.62	214	214	214		14,712,300	218	0	218	218		5,319.48	2	25,032,212	7,270,855							
															1,132.10					6,115,700																
2	HABIB	R.	KORABU A.	0513	5673	52	137								1,075.73					68,750	2,818,700	14.00		14.00	32.105	242,876	4,137,205		0							
3	KRISTO JONAN		RUGSHI PASAD	0513	5715	61	143								12,945	302,460	28.00	28.00		68,750	1,935,000								2,287,460							
4	NACHO	BAHRI	RUGSHI	0513	5716	61	144								12,945	446,285	28.00	28.00		68,750	1,935,000								2,373,285							

Fletorja Zyrtare Viti 2022 – Numri 123



Fletorja Zyrtare  Viti 2022 – Numri 123

[illegible]

1. Cmimi sipas VKM-së nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë	Cmimi (lekëm ²)
1. Trrall	12,945
2. Cmimi sipas vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive, pronë private, që shpronësohet, të pasurive që zhvërsëohen dhe të drejtave të personave të tretë, për interes publik".	
Mbështetur në shkresën e ASHK Durrës nr. 1496/1, datë 28.3.2002, protokolluar në FSHZH me nr. 736/1, datë 30.3.2002, cmimi mesatar i shërbijëve për objektet banimi për tri muajt e fundit, Bashkia Durrës, për ZR. 6513, është 68750 lekë/m ² .	Cmimi (lekëm ²)
1. Njësi apartament banimi*	68,750
2. Mbështetur në shkresën e EKB-së nr. 3332/1, datë 27.9.2021, protokolluar në FSHZH me nr. 2904/1, datë 29.9.2021, cmimi sipas VKM-së nr. 3, datë 28.12.2016, për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të Banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016, cmimi është 32,105 lekë/m ² .	Cmimi (lekëm ²)
1. Njësi shërbimi*	32,105

* Për njësiqe e shërbimi, është zbiruar amortizimi i objekteit në mbështetje të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 (përdëruar), nën titull 30.



VENDIM

Nr. 600, datë 14.9.2022

**PËR TRAJTIMIN DHE MBULIMIN E
SHPENZIMEVE FINANCIARE TË
PERSONELIT USHTARAK DHE CIVIL
TË MINISTRISË SË MBROJTJES DHE
FORCAVE TË ARMATOSURA TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, GJATË
KOHËS QË EMËROHEN ME DETYRË
JASHTË VENDIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të pikave 1, shkronja “i”, e 3, të nenit 7, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I

FUSHA E ZBATIMIT

1. Ky vendim zbatohet për ushtarakët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe punonjësit civilë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, vetëm në rastet kur në strukturë parashikohet përfaqësimi i barasvlershëm me gradat e personelit ushtarak, që emërohen me detyrë jashtë vendit dhe ushtrojnë detyrën si rezidentë në një shtet të huaj, në:

- a) misionet diplomatike të Republikës së Shqipërisë;
- b) përfaqësitë ushtarake të Republikës së Shqipërisë pranë NATO-s;
- c) stafin ndërkombëtar, stafin ushtarak ndërkombëtar, strukturën e komandës, strukturën e forcës, agjencitë dhe qendrat e NATO-s;
- c) organizatat ndërkombëtare dhe rajonale.

2. Për efekt të këtij vendimi, familjarë të personelit ushtarak dhe civil, që emërohen me detyrë jashtë vendit, janë bashkëshorti/ja, fëmijët, si dhe persona të tretë, në kujdestari, të cilët shoqërojnë personelin në detyrë.

KREU II

**TRAJTIMI DHE MBULIMI I
SHPENZIMEVE FINANCIARE PËR
PERSONELIN USHTARAK DHE CIVIL TË
MINISTRISË SË MBROJTJES DHE
FORCAVE TË ARMATOSURA TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

1. Ministria e Mbrojtjes përballon shpenzimet për sigurimin e jetës së personelit ushtarak dhe civil, që emërohet me detyrë jashtë vendit, dhe të familjarëve të tyre, në rastet kur vendi pritës konsiderohet vend me rrezikshmëri të lartë. Sigurimi i jetës do të mbulohet për sa kohë vazhdon situata e rrezikshmërisë së lartë.

1.1 Rrezikshmëri e lartë, për efekt sigurimi, sipas këtij vendimi, konsiderohen situatat kur:

- a) në shtetin pritës shpallet gjendja e luftës ose e jashtëzakonshme;
- b) në shtetin pritës mbizotërojnë situata të përkeqësuar të sigurisë dhe të rendit publik, të cilat vlerësohen të rrezikshme për jetën.

1.2 Procedurat e përzgjedhjes së shoqërive të sigurimit kryhen nga Ministria e Mbrojtjes dhe i nënshtrohen legjislacionit shqiptar në fuqi për prokurimin publik.

2. Personeli ushtarak dhe civil, që emërohet me detyrë jashtë vendit, dhe familjarët shoqërues të tyre kanë të drejtë që, për raste urgjencash të jashtëzakonshme, të cilat vënë në rrezik shëndetin e tyre, të mjekohen në vendin pritës, me miratimin e eprorit direkt dhe sipas rregullave të strukturës ku bën pjesë, kur për një gjë të tillë nuk është parashikuar sigurimi shëndetësor. Në këtë rast, shpenzimet përballohen nga Ministria e Mbrojtjes.

3. Gjatë ushtrimit të detyrës, personeli ushtarak dhe civil, që emërohet me detyrë jashtë vendit, përfiton trajtim financiar të posaçëm, për mbulimin e shpenzimeve për:

a) transport personal dhe të familjarëve shoqërues nga Republika e Shqipërisë në vendin e emërimit dhe nga vendi i emërimit për në Republikën e Shqipërisë, në momentin e marrjes dhe të përfundimit të detyrës;

b) transport të sendeve dhe orendive personale në momentin e emërimit dhe përfundimit të detyrës. Transporti i sendeve dhe orendive personale bëhet nga Ministria e Mbrojtjes, deri në masën 7,5 m³ për çdo anëtar të familjes, pa kaluar limitin e 30 m³ për çdo familje. Kur transporti do të



kryhet drejt një vendi tjetër jashtë Republikës së Shqipërisë, për shkak riemërimi, personeli ushtarak dhe civil, që emërohet me detyrë jashtë vendit, ka të drejtë të kryejë blerje nga operatorë ekonomikë të ndryshëm, brenda fondeve buxhetore të vëna në dispozicion për kryerjen e shpenzimeve. Blerja kryhet pas marrjes së jo më pak se të 3 (tri) ofertave nga operatorë ekonomikë të ndryshëm. Ofertat e operatorëve ekonomikë dërgohen në Ministrinë e Mbrojtjes, e cila bën përzgjedhjen dhe miraton ofertën më të përshtatshme;

c) qira banese/zyre, sigurim banese, pajisje banese/zyre dhe kancelari;

ç) energji elektrike, ujë, telefon fiks, internet, gaz dhe ngrohje e banesës/zyrës;

d) një veshje zyrtare civile;

dh) blerje dhe sigurim automjeti zyrtar;

e) parkim, mirëmbajtje, karburant dhe taksa të ndryshme për automjetin zyrtar;

ë) ceremoni zyrtare dhe pritjeje të personelit ushtarak dhe civil në vendin pritës;

f) organizimin e aktiviteteve publicitare, në interes të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë;

g) transport, fjetje, dieta ditore, taksë aktiviteti dhe shpenzimet për pagesa të ndryshme për udhëtime jashtë territorit të vendit pritës, kur këto kryhen në interes të Ministrisë së Mbrojtjes;

gj) transport, dieta ditore, taksë aktiviteti dhe shpenzimet për pagesa të ndryshme, si dhe për fjetje për aktivitete që organizohen brenda vendit pritës, mbi 200 km nga vendqëndrimi i përhershëm, kur këto kryhen në interes të Ministrisë së Mbrojtjes.

3.1 Ministri i Mbrojtjes përcakton me urdhër, periodikisht, kushtet kryesore të qiramarrjes për banesë/zyrë, si dhe listën e pajisjeve të nevojshme për ambientin e banimit/zyrës, në përputhje me tregun e pasurive të paluajtshme në vendin pritës dhe nevojat për prezantim.

3.2 Specifikimet dhe parashikimet e veçanta në lidhje me përballimin e shpenzimeve, të përmendura në këtë pikë, përcaktohen me udhëzim të ministrit të Mbrojtjes.

4. Personeli ushtarak dhe civil, që emërohet me detyrë jashtë vendit, ka të drejtë të kryejë blerje nga operatorë ekonomikë të ndryshëm, brenda fondeve buxhetore të vëna në dispozicion për kryerjen e shpenzimeve, të shërbimeve/mallrave, të përmendura në shkronjat “c”, “dh”, “e” dhe “g”, të

pikës 3, të këtij kreu. Blerja kryhet pas marrjes së jo më pak se të 3 (tri) ofertave nga operatorë ekonomikë të ndryshëm. Ofertat e operatorëve ekonomikë dërgohen në Ministrinë e Mbrojtjes, e cila bën përzgjedhjen dhe miraton ofertën më të përshtatshme.

5. Pagesa e komisioneve bankare për të gjitha veprimet bankare për trajtimin dhe mbulimin e shpenzimeve financiare të personelit ushtarak dhe civil që emërohet me detyrë jashtë vendit, të përmendura në këtë vendim, mbulohen nga Ministria e Mbrojtjes.

6. Me urdhër të ministrit të Mbrojtjes, për raste të veçanta për personelin ushtarak dhe civil, që emërohet me detyrë jashtë vendit, dhe familjarët shoqërues, Ministria e Mbrojtjes mbulon vetëm shpenzimet e udhëtimit për kthimin në atdhe dhe rikthimin në shtetin ku është emëruar. Raste të veçanta, në kuptim të kësaj pike do të konsiderohen rastet e fatkeqësisë familjare, bashkimit familjar, rastet e sëmundjeve të familjarëve, vërtetuar sipas dokumentacionit përkatës dhe raste të tjera të paparashikuara, por që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me personelin ushtarak dhe civil që emërohet me detyrë jashtë vendit.

7. Në rast humbjeje të jetës së personelit ushtarak dhe civil, që emërohet me detyrë jashtë vendit, apo të pjesëtarit të familjes që e shoqëron në detyrë, shpenzimet për transportin e trupit në atdhe, si dhe ato të ceremonisë mortore përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

8. Të ardhurat për barrë lindje për personelin ushtarak dhe civil, që emërohet me detyrë jashtë vendit, gjatë kohës që është në detyrë, mbulohen nga sigurimet shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

8.1 Në rast se personeli ushtarak dhe civil, që emërohet me detyrë jashtë vendit, vendos të vijojë lejen e barrë lindjes, pas periudhës 63-ditore nga lindja e fëmijës, atëherë personeli zëvendësohet në detyrë me urdhër të ministrit të Mbrojtjes. Në këtë rast, personeli i zëvendësuar në varësi të statusit që gëzon, do t'i nënshtrohet legjislacionit në fuqi.



KREU III
TRAJTIMI DHE MBULIMI I
SHPENZIMEVE FINANCIARE PËR
FAMILJARËT E PERSONELIT USHTARAK
DHE CIVIL TË MINISTRISË SË
MBROJTJES DHE FORCAVE TË
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

1. Ministria e Mbrojtjes mbulon shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe sigurimin e detyrueshëm shëndetësor të bashkëshortit/es të personelit ushtarak dhe civil, që emërohet me detyrë jashtë vendit, për periudhën që ai/ajo e shoqëron personelin në shërbim. Masa e kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për bashkëshortin/en të llogaritet, përkatësisht, si më poshtë vijon:

a) Për bashkëshortin/en, i cili/e cila përfiton pagë mujore, sipas pikës 2, të këtij kreu, kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore paguhen nga Ministria e Mbrojtjes, në përputhje me masën e pagës së përfutur dhe sipas legjislacionit shqiptar në fuqi;

b) Në rastet kur bashkëshorti/ja punësohet me kohë të pjesshme në strukturat e përcaktuara në pikën 1, të kreut I, të këtij vendimi, kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore paguhen nga Ministria e Mbrojtjes, në përputhje me parashikimet e legjislacionit shqiptar në fuqi.

2. Bashkëshorti/ja i/e personelit ushtarak dhe civil, që emërohet me detyrë jashtë vendit, përfiton pagë mujore në vlerën 50 % të pagës së pozicionit të punës, grada “nëntetar”, sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për përcaktimin e pagave dhe shtesave mbi pagë të punonjësve që shërbejnë me shërbim jashtë vendit. Paga mujore fillon pas paraqitjes pranë Ministrisë së Mbrojtjes, nga titullari i misionit ose postit të vërtetimit të shoqërimit të personelit ushtarak dhe civil që emërohet me detyrë jashtë vendit, nga bashkëshorti/ja në detyrë, në vendin pritës.

2.1 Bëjnë përjashtim nga ky rregull rastet kur bashkëshorti/ja e ushtarakut trajtohet me pagesë papunësie, sipas legjislacionit në fuqi, i cili/e cila vazhdon edhe gjatë kohës në mision.

2.2 Kjo pagë mujore i nënshtrohet ndalesave të tatimit mbi të ardhurat, sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

2.3 Në rast se bashkëshorti/ja emërohet në një vend pune në vendin pritës, humbet të drejtën e përfitimit të pagës mujore.

2.4 Bashkëshorti/ja i/e personelit ushtarak ose civil i emëruar me detyrë jashtë vendit, që nuk e shoqëron atë në detyrë në vendin pritës, nuk përfiton pagën mujore të parashikuar në këtë pikë. Bashkëshortit/es kur nuk e shoqëron personelin ushtarak ose civil, që emërohet me detyrë jashtë vendit për më shumë se 3 (tre) muaj të njëpasnjëshëm, i ndërpritet e drejta për pagë mujore.

3. Fëmijët nën moshën 18 vjeç, që jetojnë në vendin pritës me personelin ushtarak dhe civil, që emërohet me detyrë jashtë vendit, përfitojnë shpërblim mujor me vlerën 20% të pagës së gradës “nëntetar”, sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, për përcaktimin e pagave dhe shtesave mbi pagë të punonjësve që shërbejnë me shërbim jashtë vendit. Ky shpërblim i nënshtrohet tatimit mbi të ardhurat, sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Trajtimi financiar i fëmijës paguhet në llogarinë e personelit ushtarak dhe civil që emërohet me detyrë jashtë vendit.

4. Në rastet kur në vendin pritës çerdhet publike, kopshtet publike dhe shkollat publike janë me pagesë, shpenzimet përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes deri në përfundimin e arsimit të mesëm. Pagesa kryhet me miratimin e ministrit të Mbrojtjes, pas paraqitjes të dokumentacionit që vërteton masën e pagesës mujore/vjetore që duhet paguar, të lëshuar nga institucioni çerdhja, kopshti, shkolla publike përkatëse.

5. Në rastet kur në shtetin pritës programi mësimor në çerdhet publike, kopshtet publike dhe shkollat publike nuk zhvillohet në anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht, spanjisht, shkollimi i fëmijëve të personelit ushtarak dhe civil, që emërohet me detyrë jashtë vendit, mund të bëhet në shkolla private të licencuara. Në këto raste, me miratimin e ministrit të Mbrojtjes mbulohet tarifa për shkollimin e fëmijëve, deri në masën 2 500 (dy mijë e pesëqind) euro në vit. Mbulimi i këtyre shpenzimeve bëhet nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes. Shpenzimet e tjera të shkollimit, si pagesa e librave, transporti, pjesëmarrja në aktivitete kulturore, sportive etj., përballohen nga personeli ushtarak dhe civil që emërohet me detyrë jashtë vendit.



KREU IV
DISPOZITA TË FUNDIT DHE
KALIMTARE

1. Rregullat e përcaktuara në pikën 3.1, të kreut II, të këtij vendimi, do të zbatohen vetëm për kontratat e qirasë, të lidhura pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Vendimi nr. 305, datë 12.3.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e shpenzimeve të atashëve ushtarakë, të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, që shërbejnë në shtabet e NATO-s e në përfaqësitë ushtarake të Republikës së Shqipërisë pranë NATO-s, dhe të ushtarakëve shqiptarë, që shërbejnë pranë organizatave ndërkombëtare dhe në shtabet ushtarake ndërkombëtare”, i ndryshuar, shfuqizohet.

4. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 601, datë 14.9.2022

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË
VENDEVE TË TRETA,
SI SHTETE TË TRETA TË SIGURTA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 10, të ligjit nr. 10/2021, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së vendeve të treta, si shtete të treta të sigurta, sipas shtojcës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Vendimi nr. 159, datë 2.3.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së vendeve të treta të sigurta”, shfuqizohet.

3. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

SHTOJCA NR. 1
LISTA E VENDEVE TË TRETA, SI SHTETE
TË TRETA TË SIGURTA

Vendet që përfshihen në listën e shteteve të treta të sigurta, paraqiten në vijim:

1. Principata e Andorrës
2. Australia
3. Republika e Austrisë
4. Mbretëria e Belgjikës
5. Republika e Bosnjë-Hercegovinës
6. Republika e Bullgarisë
7. Mbretëria e Danimarkës
8. Republika e Estonisë
9. Republika e Finlandës
10. Republika e Francës
11. Republika e Greqisë
12. Republika Federale e Gjermanisë
13. Mbretëria e Holandës
14. Republika e Hungarisë
15. Republika e Italisë
16. Republika e Irlandës
17. Republika e Islandës
18. Japoni
19. Kanada
20. Republika e Koresë
21. Republika e Kosovës
22. Republika e Kroacisë
23. Republika e Letonisë
24. Republika e Lituaniës
25. Dukati i Madh i Luksemburgut
26. Republika e Malit të Zi
27. Republika e Maltës
28. Mbretëria e Bashkuar
29. Mbretëria e Norvegjisë
30. Republika e Polonisë
31. Republika e Portugalisë
32. Republika e Qipros
33. Republika e Çekisë
34. Republika e Maqedonisë së Veriut
35. Republika e Rumanisë
36. Republika e Serbisë



37. Republika e Sllovakisë
38. Republika e Sllovenisë
39. Mbretëria e Spanjës
40. Mbretëria e Suedisë
41. Shtetet e Bashkuara të Amerikës
42. Republika e Turqisë
43. Zelanda e Re
44. Konfederata Zvicerane
45. Principata e Monakos
46. Principata e Lihtenshtajnit
47. Republika e San Marinosit
48. Shteti i Vatikanit

VENDIM

Nr. 602, datë 14.9.2022

PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QENDRËS SË TRAJNIMIT TË ADMINISTRATËS TATIMORE DHE DOGANORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore (në vijim, Qendra), si person juridik publik buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për financat (në vijim, ministri), me seli në Tiranë.

2. Qendra ka për mision të sigurojë që kapacitetet e burimeve njerëzore të administratës tatimore dhe doganore në fushën fiskale të jenë në nivele të larta, me qëllim rritjen e performancës së tyre në kryerjen e detyrave dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve, që ofrojnë këto administrata ndaj tatimpaguesve.

3. Fushat e përgjegjësisë së Qendrës janë:

a) forcimi i njohurive specifike të nëpunësve të administratës tatimore dhe doganore në fushën fiskale nëpërmjet trajnimeve;

b) kërkimet studimore dhe analizat në fushën fiskale;

c) botimi i studimeve në fushën fiskale;

ç) krijimi i njohurive specifike fiskale për nëpunësit e administratës shtetërore, që kanë lidhje me fushën fiskale, sipas kërkesës dhe kur është e mundur nga Qendra.

4. Qendra financohet nga buxheti i shtetit dhe nga burime të tjera të ligjshme.

KREU II PËRGJEGJËSITË FUNKSIONALE TË QENDRËS SË TRAJNIMIT TË ADMINISTRATËS TATIMORE DHE DOGANORE

5. Qendra ka përgjegjësi funksionale të organizojë punën për:

a) hartimin dhe zbatimin e programeve të trajnimit në fushën fiskale;

b) zhvillimin e procesit të trajnimit, përfshirë përzgjedhjen e trajnerëve dhe vlerësimin e të trajnuarve;

c) përgatitjen e botimeve në fushën fiskale kur Qendra ka kapacitetet dhe mundësitë e duhura.

6. Qendra ushtron përgjegjësi funksionale, të përcaktuara në pikën 5, të këtij vendimi, kryerja e të cilave kërkon shkallë të lartë specializimi në fushën fiskale.

KREU III ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I QENDRËS SË TRAJNIMIT TË ADMINISTRATËS TATIMORE DHE DOGANORE

7. Qendra e shtrin veprimtarinë e saj për administratën tatimore dhe doganore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe organizohet në nivel qendror, në formën e Drejtorisë së Përgjithshme.

8. Struktura dhe organika e Qendrës miratohet me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

9. Qendra drejtohet nga drejtori i Përgjithshëm, i cili përgjigjet përpara ministrit dhe e përfaqëson atë në marrëdhënie me të tretët.

10. Marrëdhëniet e punës së drejtorit të Përgjithshëm, nëpunësve të Qendrës dhe trajnerëve të brendshëm rregullohen në bazë të dispozitave të legjislacionit për nëpunësin civil. Marrëdhëniet e



punës së punonjësve administrativë rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës. Trajnerët e jashtëm kontraktohen nëpërmjet kontratave të shërbimit.

11. Rregullorja që përcakton metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të Qendrës miratohet nga ministri, pas propozimit të drejtorit të Përgjithshëm të Qendrës.

12. Rregullorja e trajnimeve, që përmban rregullat për zhvillimin e trajnimeve, organizimin e testimit në përfundim të trajnimeve, vlerësimin e të trajnuarve, si dhe bashkëpunimin e Qendrës me administratën tatimore dhe doganore miratohet nga ministri, pas propozimit të drejtorit të Përgjithshëm të Qendrës.

13. Pranë Qendrës ngrihet dhe funksionon Këshilli Konsultativ, me qëllim këshillimin e saj në lidhje me politikat dhe strategjitë e trajnimit në fushën fiskale dhe programet e trajnimit.

14. Këshilli Konsultativ ka këtë përbërje:

a) zëvendësministri përgjegjës për financat, i emëruar nga ministri, kryetar;

b) drejtori i përgjithshëm i Tatimeve, anëtar;

c) drejtori i përgjithshëm i Doganave, anëtar;

ç) drejtori i drejtorisë përgjegjëse për politikat fiskale dhe makroekonomike, në ministrinë përgjegjëse për financat, anëtar;

d) drejtori i përgjithshëm i Qendrës, anëtar.

15. Gjatë punës së tij, Këshilli Konsultativ bazohet në legjislacionin përkatës për funksionimin e organeve të ngjashme, në lidhje me rregullat e votimit, rendin e ditës, kuorumin dhe çështje të tjera të funksionimit të Këshilli Konsultativ.

16. Qendra ka këto detyra:

a) organizon trajnime specifike fiskale: bazë, funksionale dhe të vazhdueshme;

b) harton programet e trajnimit përkatëse, në bashkëpunim me organet tatimore dhe doganore, në përputhje me nevojat e tyre;

c) lëshon certifikatën përkatëse të trajnimit për punonjësit dhe nëpunësit e administratës tatimore dhe doganore, pjesëmarrës në trajnim;

ç) bashkëpunon me institucione të ngjashme dhe organizata brenda dhe jashtë vendit, sipas rregullave në fuqi;

d) kryen kërkime studimore dhe analiza në fushën fiskale kur kërkohet;

dh) dorëzon propozime, zbaton vetë ose në bashkëpunim me institucione dhe organizma publikë ose privatë dhe monitoron projekte

përkatëse në fushën fiskale e të forcimit të kapaciteteve të organeve tatimore dhe doganore, brenda rolit e detyrave të Qendrës, të përcaktuara në këtë vendim kur kërkohet;

e) dërgon për këshillim pranë Këshillit Konsultativ programet e trajnimit;

ë) dërgon për njohje pranë Këshillit Konsultativ raportin vjetor të veprimtarisë;

f) raporton jo më pak se dy herë në vit para ministrit përgjegjës të financave.

17. Qendra ka stemën, logon dhe vulën zyrtare. Stema e Qendrës përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet “Republika e Shqipërisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore”, në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

18. Vula e Qendrës ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, administrimit dhe kontrollit të vulave zyrtare. Vula prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KREU IV

PROGRAMET E TRAJNIMIT TË OFRUARA NGA QENDRA DHE TARIFAT

19. Në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe, bazuar në vlerësimin e nevojave të kryera, përkatësisht, nga këto dy drejtori të përgjithshme, Qendra harton:

a) programe të trajnimeve specifike fiskale bazë për punonjësit dhe nëpunësit e rinj të administratës tatimore dhe doganore, të punësuar dhe emëruar rishtazi, ata me kohëzgjatje jo më shumë se 1 (një) vit punë, me qëllim që të pajisen me njohuri të rëndësishme themelore përkatëse;

b) programe të trajnimeve funksionale specifike fiskale për punonjësit dhe nëpunësit e administratës tatimore dhe doganore, për specializim në vendin e punës, për zhvillimin e karrierës, ku njohuritë themelore dhe të përgjithshme thellohen përmes trajnimit, që lidhet me funksionet përkatëse administrative;

c) programe të trajnimeve të vazhdueshme specifike fiskale për të gjithë punonjësit dhe nëpunësit e administratës tatimore dhe doganore,



të cilat përqendrohen në shkëmbimin e përvojave, transferimin e njohurive dhe dialogun ndërmjet stafit, përditësimin me legjislacionin dhe praktikën e reja të zbatueshme në administratën tatimore dhe doganore.

20. Qendra ofron trajnime për nëpunës jashtë administratës tatimore dhe doganore, që kanë lidhje me fushën fiskale, kur:

a) një institucion i administratës shtetërore, institucion i pavarur ose njësi e vetëqeverisjes vendore paraqet kërkesën për trajnimin e nëpunësve të tij;

b) ka kapacitetet e duhura të lira dhe nuk pengon realizimin e përgjegjësiwe funksionale për kryerjen e trajnimeve të planifikuara për nëpunësit e administratës tatimore dhe doganore;

c) për zhvillimin e trajnimit të tyre, nuk kërkojnë shpenzime shtesë ose, kur këto shpenzime mbulohen nga fondet e buxhetit të shtetit;

ç) rregullat e organizimit parashikohen në rregulloren e trajnimeve të Qendrës.

21. Trajnimet zhvillohen me pjesëmarrje fizike në sallë ose me pjesëmarrje *online*. Trajnime zhvillohen edhe si kombinim i pjesëmarrjes fizike në sallë dhe pjesëmarrjes *online*. Qendra ofron trajnime në distancë, sipas kërkesës, të cilat ndiqen individualisht prej nëpunësve, që plotësojnë kushtet për t'u trajnuar në fushën e tatimeve dhe doganave. Rregullat për provueshmërinë e pjesëmarrjes përcaktohen në rregulloren e trajnimeve të Qendrës.

22. Qendra bashkëpunon me qendra, shkolla, institucione të tjera, universitete dhe organizma trajnimi, në bazë të marrëveshjeve, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

23. Trajnime për punonjësit dhe nëpunësit e administratës tatimore dhe doganore jepen pa pagesë dhe gjatë kohës së trajnimit nëpunësi merr pagën e plotë. Punonjësit e tjerë të administratës shtetërore përfitojnë trajnimin pa pagesë, në rastet kur ka kërkesë nga institucionet përkatëse.

24. Përsëritësit e programeve të trajnimit do të paguajnë 10 000 (dhjetë mijë) lekë për program.

25. Njohuritë dhe aftësitë e fituara gjatë trajnimit bazë testohen me shkrim në “testimet e njohurive”, të organizuar në fund të procesit të trajnimit, për punonjësit, nëpunësit e rinj. Për kategoritë e trajnimit të vazhdueshëm dhe trajnimit funksional, të përcaktuar në këtë vendim, në fund

të trajnimit përkatës organizohen “testime të performancës” në trajnim. Në fund të procesit, të gjitha kategoritë e pjesëmarrësve në trajnime, që kalojnë me sukses testimin përkatës, pajisen me certifikatë.

26. Rregullat e vlerësimit, testimit dhe konfirmimit të marrjes së trajnimeve përkatëse përcaktohen në rregulloren e trajnimeve të Qendrës.

27. Shkolla Shqiptare e Administratës Publike bashkëpunon me Qendrën, në lidhje me përmbajtjen e trajnimit të detyrueshëm të nëpunësve në periudhë prove të njëjësive që realizojnë funksionet, për të cilat është krijuar dhe funksionon administrata tatimore dhe doganore.

KREU V KRITERET PËR TRAJNERËT DHE PAGESA E TYRE

28. Qendra ka këto kategori të trajnerëve:

a) trajnerë të brendshëm; dhe

b) trajnerë të jashtëm.

29. Kriteret e përgjithshme për trajnerët e jashtëm, të cilët ofrojnë shërbimet e tyre për Qendrën, bazuar në legjislacionin e zbatueshëm për këtë kategori shërbimesh, janë, si më poshtë vijon:

a) të punojnë ose të kenë eksperiencë pune në organet fiskale;

b) të jenë asistent lektor/lektor/profesor;

c) të kenë ekspertizën që kërkojnë programet specifike të trajnimit.

30. Për zhvillimin e trajnimeve, Qendra të lidhë me trajnerët e jashtëm kontrata shërbimi me objektin e mëposhtëm:

a) kontratë për trajnimin e punonjësve dhe nëpunësve të administratës tatimore dhe doganore e të tjerë;

b) kontratë për hartimin e kurrikulave dhe materialeve trajnuese;

c) kontratë për trajnimin e trajnerëve (ToT), kur është e nevojshme.

31. Trajnerët e jashtëm, me të cilët lidhen kontratat, sipas shkronjave “a” dhe “c”, të pikës 30, të këtij vendimi, ndahen në kategoritë e mëposhtme:

a) trajnerë të jashtëm të kategorisë së ulët, trajnerët që kanë një diplomë “Master i shkencave” ose “Master i arteve” ose “Master profesional, të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë, me



120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike” apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, dhe 3–5 vite përvojë pune në fushën përkatëse, për të cilën do të ofrojnë trajnimin;

b) trajnerë të jashtëm të kategorisë së mesme, trajnerët që kanë një diplomë “Master i shkencave” ose “Master i arteve” ose “Master profesional të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike” apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, dhe 6–10 vite përvojë pune në fushën përkatëse, për të cilën do të ofrojnë trajnimin;

c) trajnerë të jashtëm të kategorisë së lartë, trajnerët që kanë një diplomë “Master i shkencave” ose “Master i arteve” ose “Master profesional të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike” apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, dhe mbi 11 vite përvojë pune në fushën përkatëse, për të cilën do të ofrojnë trajnimin.

32. Trajnerë të jashtëm, me të cilët lidhen kontratat e parashikuara në shkronjën “b”, të pikës 30, zgjidhen individët që plotësojnë kriteret për të qenë trajnerë të jashtëm të kategorisë së lartë.

33. Masa e pagesës për trajnerët e jashtëm përcaktohet në kontratë dhe llogaritet në varësi të kategorisë së trajnerit e të orëve të trajnimit, përkatësisht:

a) për kontratat e parashikuara në shkronjat “a” dhe “c”, të pikës 30, të këtij vendimi, masa e pagesës për çdo orë trajnimi 60-minutëshe për:

i. trajnerët e jashtëm të kategorisë së ulët të jetë 750 (shtatëqind e pesëdhjetë) lekë;

ii. trajnerët e jashtëm të kategorisë së mesme të jetë 1 000 (një mijë) lekë;

iii. trajnerët e jashtëm të kategorisë së lartë të jetë 1 500 (një mijë e pesëqind) lekë;

b) për kontratat e parashikuara në shkronjën “b”, të pikës 30, të këtij vendimi, masa e pagesës për hartimin e kurrikulave apo të materialeve të trajnimit, të nevojshme për zhvillimin e 6 orëve 60-minutëshe, të jetë 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë;

c) në rastet e hartimit të kurrikulave apo të materialeve të trajnimit për më pak ose më shumë se 6 orë trajnimi 60-minutëshe, pagesa llogaritet në përpjesëtim me orët e trajnimit;

ç) në rastet e rishikimit të kurrikulave, pagesa të jetë deri në 50% të pagesës së përcaktuar, sipas shkronjës “b”, të kësaj pike.

KREU VI BOTIMET DHE PRODUKTET INTELEKTUALE

34. Qendra bën botime ose publikime në fushat përkatëse.

35. E drejta e autorit për botimet dhe publikimet e kryera, të krijuara nga trajnerët, përfshirë trajnerët e jashtëm, apo nga personat që trajnohen nga Qendra, në kuadër të trajnimeve përkatëse i përket vetëm Qendrës.

KREU VII DISPOZITA TË FUNDIT

36. Vendimi nr. 1264, datë 16.12.2009, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe funksionimin e Qendrës së Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore”, shfuqizohet.

37. Ngarkohet Qendra t’i propozojë për miratim ministrit përgjegjës për financat rregulloren e brendshme.

38. Nëpunësit dhe asetet e Qendrës së krijuar me vendimin nr. 1264, datë 16.12.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe funksionimin e Qendrës së Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore”, transferohen në Qendrën e krijuar me këtë vendim.

39. Ngarkohen ministria përgjegjëse për financat dhe Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 1 janar 2023 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

**UDHËZIM****Nr. 174, datë 12.9. 2022****MBI PROCEDURAT E TRAJTIMIT TË
TË HUAJVE ME QËNDRIM TË
PARREGULLT NË TERRITORIN E
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, dhe në zbatim të neneve 9, pika 3, 99, pika 9, 102, pika 7, 105, pika 4, 109, pika 4, dhe 122, pika 5, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, me qëllim harmonizimin e procedurave për trajtimin e shtetasve të huaj të parregullt në Republikën e Shqipërisë,

UDHËZOJ:**KATEGORIZIMI I TË HUAJVE ME
QËNDRIM TË PARREGULLT NË
TERRITORIN E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË GJATË PROCESIT TË
PËRZGJEDHJES**

1. Autoriteti vendor për kufirin dhe migracionin është autoriteti shtetëror përgjegjës për kryerjen e procedurës së përzgjedhjes së të huajit, i cili nuk plotëson ose nuk plotëson më kushtet për hyrje dhe qëndrim në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Procesi i përzgjedhjes kryhet në kufi ose brenda territorit dhe ka për qëllim përcaktimin e kategorisë së të huajit, duke e klasifikuar atë, si:

- a) subjekt i refuzimit të hyrjes;
- b) kërkues i mbrojtjes ndërkombëtare;
- c) viktimë e mundshme trafikimi;
- d) imigrant i parregullt;
- e) i mitur i pashoqëruar.

**I. PROCEDURA E REFUZIMIT TË
HYRJES NË KUFIT**

1. Gjatë kontrollit të dokumentacionit dhe të intervistimit paraprak, si fazë fillestare të përzgjedhjes të të huajit në hyrje në territorin e Republikës së Shqipërisë, konstatohet ose dyshohet se i huaji nuk plotëson kriteret për hyrjen në RSH, ai/ajo kalohet për kontroll më të detajuar në vijë të dytë. Kontrolli në vijë të dytë kryhet nga personeli i ngarkuar për këtë qëllim. Për të huajin e mitur, në procedurën e intervistimit sigurohet prania e të rriturit që e shoqëron ose ndihma përkatëse e

punonjësit social apo e psikologut për këtë kategori, ndërsa për të huajin e gjinisë femër, intervistimi bëhet nga një punonjëse e policisë. Intervistimi kryhet në gjuhën e të huajit ose në gjuhën të cilën ai/ajo kupton.

2. Gjatë intervistimit, kur konstatohet se i huaji nuk plotëson kriteret për të hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë, të huajit i komunikohet refuzimi i hyrjes në territor nëpërmjet formularit të plotësuar, sipas modelit në aneksin nr. 1 të këtij udhëzimi, bën shënimet në dokumentin e udhëtimit të të huajit subjekt refuzimi, sipas modelit në aneksin nr. 2 të këtij udhëzimi, bën shënimet në sistemin e kontrollit kufitar të hyrje-daljeve (TIMS), si dhe merr masa për kthimin e të huajit, duke bashkëpunuar nëse është e nevojshme me transportuesin që e ka transportuar atë në pikën e kalimit kufitar, sipas përcaktimeve në pikën 3, të nenit 132, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”.

3. Në rast se gjatë intervistimit konstatohet se i huaji përdor dokument të falsifikuar apo të shpallur në kërkim si dokument i humbur/vjedhur, atëherë bllokohet dokumenti i udhëtimit, hartohet raporti i ngjarjes dhe plotësohet akti i refuzimit të hyrjes në territor ose, bazuar në vlerësimin e rastit, ia kalon oficerit të policisë gjyqësore për veprime të mëtejshme procedurale ndaj të huajit.

4. Akti i refuzimit të hyrjes, së bashku me fotokopjen e dokumentit të udhëtimit të bllokuar, si dhe një kopje të aktit të bllokimit, i jepet të huajit subjekt kthimi ose transportuesit. Punonjësi i cili ka konstatuar dokumentin e falsifikuar apo të deklaruar si të humbur/vjedhur, bën shënimet në sistemin TIMS në rubrikën “Refuzim hyrjeje”. Dokumenti i udhëtimit të bllokuar në pikën e kalimit kufitar, së bashku me dokumentacionin shoqërues dërgohet brenda 10 ditëve nëpërmjet autoritetit shtetëror përgjegjës vendor për trajtimin e të huajve pranë autoritetit shtetëror qendror përgjegjës për trajtimin e të huajve, i cili e përcjell zyrtarisht në Ministrinë Për Evropën dhe Punët e Jashtme.

5. Autoriteti shtetëror përgjegjës vendor për trajtimin e të huajve, ndjek procedurën e ekzekutimit vullnetar të gjobës së vendosur nga autoriteti i pikës së kalimit kufitar. Në rast se pas përfundimit të afatit të përcaktuar në legjislacionin për kundërvajtjet administrative rezultojnë se transportuesi nuk ka bërë likuidimin e gjobës, atëherë autoriteti shtetëror përgjegjës vendor për



trajtimin e të huajve aplikon ekzekutimin me forcë të gjobës, sipas përcaktimeve në kapitullin VII të këtij udhëzimi.

6. Në rast se i huaji, subjekt i refuzimit të hyrjes në kufi, për arsye të ndryshme, nuk mund të kthehet menjëherë, autoriteti në PKK vendos mbajtjen e tij në zonën e caktuar për këtë kategori personash, deri në marrjen e masave për largimin e tij nga territori. Të gjitha shpenzimet për mbajtjen e të huajit në një zonë të caktuar, me qëllim kthimin e menjëhershëm të tij, mbulohen nga transportuesi. Trajtimi i të huajit në këtë zonë bëhet në kushte të njëjta me ato të ndalimit në Qendrën e Mbyllur. Në rast se afati i ndalimit të të huajit, subjekt i refuzimit të hyrjes në kufi, diktuar nga kushte të ndryshme, parashikohet të kalojë 24 orë, atëherë autoriteti shtetëror përgjegjës vendor për trajtimin e të huajve, dërgon të huajin pranë Qendrës së Mbyllur, duke ndjekur procedurën e ndalimit në Qendër. Sistemimi i të huajit në një zonë të caktuar, me qëllim prapësimin e tij në kufi, nuk konsiderohet hyrje në territor, pavarësisht vendndodhjes së kësaj zone. Zonat për mbajtjen e të huajve në pikën e kalimit kufitar, caktohen nga autoriteti shtetëror përgjegjës vendor për trajtimin e të huajve në juridiksionin e të cilit ndodhen pikat e kalimit kufitar.

II. PROCEDURAT E PËRZGJEDHJES SE SHETETASIT TË HUAJ, I CILI NUK PLOTËSON OSE QË NUK I PLOTËSON MË KUSHTET PËR QËNDRIM NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

1. Procesi i përzgjedhjes përfundon maksimalisht brenda 10 orëve nga momenti i shoqërimit. Në rastin e tejkalimit të këtij orari për arsye të justifikueshme, informohet autoriteti shtetëror përgjegjës vendor për trajtimin e të huajve dhe bëhet shënim në Regjistrin Kombëtar Elektronik për të huajt (moduli “Të huajt e parregullt”).

2. Në rast se shërbimi i policisë kufitare dhe i migracionit konstaton/kap të huaj me qëndrim të parregullt në kufi apo në territor, njofton eprorin e tyre të drejtpërdrejtë, bën kontrollin e imtësishëm fizik për të evidentuar prova për shtetësinë ose shtetin nga ka ardhur i huaji, përpilon raportin e shërbimit, duke përshkruar gjithçka me saktësi dhe, nën masa sigurie, kryen shoqërimin e të huajit me qëndrim të parregullt pranë autoritetit përgjegjës (PKK, Komisariat apo DRKM). Procesi i

përzgjedhjes (daktiloskopimi, identifikimi) kryhet nga DRKM-ja, Komisariati për Kufirin dhe Migracionin apo pika e kalimit kufitar. Procesi i daktiloskopimit kryhet në bashkëpunim me strukturat e policisë në qarqe (policia shkencore) apo nga pika e kalimit kufitar. Procesi i identifikimit kryhet në bashkëpunim me strukturat vendore të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe strukturat vendore të Drejtorisë së Antiterrorit në Drejtorinë e Policisë së Shtetit. Për raste të veçanta, me kërkesë të përfaqësuesit të SHISH-it, vijimi i intervistimit mund të lejohet vetëm me përfaqësuesin e këtij institucionit.

3. Në rast se shërbimet e tjera të Policisë së Shtetit konstatojnë/kapin shtetas të huaj me qëndrim të parregullt në territor, pasi kryejnë detyrimet e parashikuara ligjore apo normative, e shoqërojnë atë në ambientet e drejtorisë vendore për kufirin dhe migracionin/komisariatit të policisë kufitare në juridiksionin territorial të së cilës konstatohet/kapet shtetasi i huaj i parregullt, duke e dorëzuar kundrejt një raporti shërbimi.

4. Në rast se në procedurën e përzgjedhjes i huaji përcaktohet si kërkues i mbrojtjes ndërkombëtare, autoriteti përgjegjës vendor për trajtimin e të huajve (pasi plotëson formularin sipas modelit në aneksin 3 të këtij udhëzimi), njofton menjëherë autoritetin qendror shtetëror përgjegjës për trajtimin e azilkërkuesve dhe refugjatëve, si dhe autoritetin shtetëror qendror përgjegjës për trajtimin e të huajve. Autoriteti shtetëror përgjegjës vendor bashkërendon punën për transportin dhe shoqërimin e kërkuesit të mbrojtjes ndërkombëtare në Qendrën Kombëtare Pritëse për Azilkërkues në Tiranë dhe e dorëzon kërkuesin e mbrojtjes ndërkombëtare pranë këtij autoriteti kundrejt procesverbalit të dorëzimit, i cili mbahet në dy kopje, sipas modelit në aneksin nr. 4 të këtij udhëzimi. Një kopje e procesverbalit i jepet punonjësit të Qendrës Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit, ndërsa kopja tjetër mbahet nga autoriteti vendor për kufirin dhe migracionin. I gjithë informacioni hidhet në Regjistrin Kombëtar për të Huajt (moduli “Të huajt e parregullt”) dhe pasqyrohet në komunikatën ditore të punës.

5. Në rast se në procedurën e përzgjedhjes konstatohen kushtet për ndalimin/arrestimin e të huajit kërkues i mbrojtjes ndërkombëtare, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi, autoriteti vendor për trajtimin e të huajve bën



ndalimin/arrestimin e tij dhe ndjek procedurat e mëtejshme ligjore të parashikuara. Në vazhdim njoftohet struktura përgjegjëse pranë autoritetit shtetëror qendror përgjegjës për trajtimin e të huajve, e cila njofton autoritetin shtetëror përgjegjës për azilin dhe refugjatët. I gjithë informacioni hidhet në Regjistrin Kombëtar Elektronik për të Huajt (moduli “Të huajt e parregullt”) dhe pasqyrohet në komunikatën ditore të punës.

6. Në rast se në procedurën e përzgjedhjes konstatohen elemente që lënë të dyshohet për një viktimë të trafikimit apo viktimë të mundshme të trafikimit, autoriteti vendor për trajtimin e të huajve, referuar Udhëzuesit për Zbatimin e Procedurave Standarde të Veprimit për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave të Trafikimit dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit, njofton menjëherë strukturat e Luftës Kundër Trafikeve të Paligjshme në Drejtorinë e Policisë së Qarkut dhe dorëzon të huajin kundrejt procesverbalit të dorëzimit, i cili bëhet në dy kopje, pranë këtyre strukturave. I gjithë informacioni hidhet në Regjistrin Kombëtar Elektronik për të Huajt (moduli “Të huajt e parregullt”) dhe pasqyrohet në komunikatën ditore të punës.

7. Në rast se në procedurën e përzgjedhjes, i huaji përcaktohet si imigrant me qëndrim të parregullt, struktura përgjegjëse pranë autoritetit shtetëror përgjegjës vendor për trajtimin e të huajve, referuar rasteve, përpilon aktet përkatëse të parashikuara në ligjin nr. 79/2021, “Për të huajt”. I gjithë informacioni hidhet në Regjistrin Kombëtar Elektronik për të Huajt (moduli “Të huajt e parregullt”) dhe pasqyrohet në komunikatën ditore të punës.

8. Kur konstatohet se i huaji, subjekt i procedurës së përzgjedhjes, është i/e mitur i/e pashoqëruar, autoriteti shtetëror përgjegjës vendor për trajtimin e të huajve, brenda 12 orëve nga konstatimi apo njoftimi se në territorin e Republikës së Shqipërisë është konstatuar, është paraqitur apo qëndron një fëmijë i pashoqëruar, referon rastin te punonjësi për mbrojtjen e fëmijës (në vijim “PMF”) në territorin e së cilës është konstatuar prania e fëmijës së pashoqëruar, vendndodhjen e saktë të fëmijës, si dhe çdo të dhënë tjetër që tregon mënyrën e trajtimit e gjendjen e tij. Deri në përcaktimin e moshës sipas

legjislacionit në fuqi, ai prezumohet se është i mitur dhe trajtohet si i tillë.

9. Fëmija i pashoqëruar nuk mund të jetë në asnjë rast subjekt i ndonjë vendimi kthimi në pikat e kalimit të kufirit. Në rastet e tjera, kthimi është alternativa e fundit dhe vetëm në raste kur është në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës dhe legjislacionin në fuqi.

III. PROCEDURAT E KTHIMIT TË FËMIJËS SË HUAJ TË PASHOQËRUAR

1. Pas njohjes me mendimin e arsyetuar të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen dhe të Drejtat e Fëmijës, parashikuar në VKM-në nr. 111, datë 6.3.2019, “Mbi procedurat dhe rregullat e riatdhesimit të fëmijës”, lidhur me situatën e fëmijës, autoriteti shtetëror përgjegjës vendor për trajtimin e të huajve, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, nëse vlerëson se fëmija i pashoqëruar duhet të kthehet, atëherë lëshon urdhrin e largimit apo dëbimit.

2. Urdhri i largimit apo dëbimit të fëmijës së pashoqëruar i njoftohet menjëherë Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen dhe të Drejtat e Fëmijës dhe PMF-së që ka ndjekur zbatimin e planit individual të mbrojtjes së fëmijës.

3. Fëmija i pashoqëruar, nëpërmjet kujdestarit ligjor të caktuar, ka të drejtën e ankimit administrativ dhe gjyqësor, sipas legjislacionit në fuqi. Ai përfiton ndihmë juridike falas nga shteti, nëse e kërkon një gjë të tillë, sipas rregullave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

4. Urdhri i largimit apo i dëbimit nuk ekzekutohet deri në përfundimin e procesit të ankimit dhe marrjen e vendimit përfundimtar të formës së prerë, përveçse kur është përcaktuar ndryshe në legjislacionin për të huajt.

5. Brenda 3 (tri) ditëve nga momenti i nxjerrjes së urdhrit për largimin e fëmijës së pashoqëruar dhe kthimin e tij, autoriteti shtetëror përgjegjës për trajtimin e të huajve, në koordinim me autoritetin vendor përgjegjës për trajtimin e të huajve, përgatit planin e kthimit të fëmijës, duke bashkëpunuar me autoritetet përgjegjëse të vendit ku do të kthehet fëmija.

6. Autoriteti shtetëror përgjegjës për trajtimin e të huajve njofton, drejtpërsëdrejti ose nëpërmjet kanalit diplomatik autoritetin kompetent në vendin ku fëmija do të kthehet, kthimin e fëmijës, me qëllim marrjen e masave prej tyre për të siguruar mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të fëmijës.



7. Autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin merr masa për të pajisur fëmijën me dokument të vlefshëm udhëtimi, nëse është e nevojshme.

8. Në përcaktimin e mënyrës së kthimit dhe rrugës më të përshtatshme për transportin e fëmijës mbahet në konsideratë interesi më i lartë i fëmijës dhe mundësia për të siguruar kthimin më të lehtë, të shpejtë dhe të përshtatshëm të tij, në përputhje me moshën dhe mundësinë për të përballuar pa asnjë vështirësi kthimin, duke garantuar dinjitetin e fëmijës.

9. Autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin në bashkëpunim me PMF-në, me ndihmën e një psikologu apo të një të rrituri, informon fëmijën në gjuhën që ai kupton dhe në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar me planin e kthimit të fëmijës, situatën e përgjithshme sociale, ekonomike, si dhe shërbimet që do t'i ofrohen në vendin e origjinës.

10. Fëmija shoqërohet nga kujdestari i tij ligjor gjatë udhëtimit e deri në dorëzimin tek autoritetet përgjegjëse të vendit të kthimit. Nëse rrethanat nuk e mundësojnë shoqërimin nga kujdestari ligjor, fëmija shoqërohet nga një psikolog i mbështetur nga punonjës të policisë kufitare dhe migracionit.

11. Dorëzimi i fëmijës tek autoritetet përgjegjëse të vendit të kthimit dokumentohet rregullisht, nëpërmjet procesverbalit të dorëzimit të fëmijës. Procesverbali nënshkruhet në tri kopje nga personat përgjegjës që kanë marrë në dorëzim fëmijën dhe personi përgjegjës për shoqërimin e tij. Një kopje e procesverbalit i dërgohet agjencisë.

12. Shpenzimet për kthimin e fëmijës deri në momentin e dorëzimit, në rast se nuk mbulohen nga vendi ku do të kthehet fëmija ose nga familja e fëmijës, përballohen sipas dispozitave ligjore në fuqi. Në përputhje me parimin e reciprocitetit apo të marrëveshjeve ndërkombëtare të zbatueshme, të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë, mund të kërkohej rimbursimi i shpenzimeve nga vendi ku fëmija kthehet apo nga familja e tij.

IV. PROCEDURA E LARGIMIT/DËBIMIT TË TË HUAJIT NGA TERRITORI

1. Autoriteti shtetëror përgjegjës vendor për trajtimin e të huajve, pas përzgjedhjes së të huajt si imigrant me qëndrim të parregullt, nëse konstaton se përmbushen kushtet e nenit 99 dhe të nenit 101, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, nxjerr urdhrin e largimit për të huajin, sipas modelit në aneksin nr. 5

të këtij udhëzimi dhe i komunikon të huajt në gjuhën që kupton ose së paku në gjuhën angleze, urdhrin e largimit, si dhe detyrimet që rrjedhin nga ky akt. Një kopje e urdhrin të largimit, të nxjerrë nga autoriteti vendor për kufirin dhe migracionin dhe një kopje e praktikës, dërgohet për njohje, brenda 7 ditëve pune, pranë autoritetit shtetëror qendror përgjegjës për trajtimin e të huajve.

2. Afati i ndalimit të hyrjes përcaktohet në urdhrin e largimit. Në rast të mungesës së shënimeve në sistemin e kontrollit kufitar, i huaji duhet të provojë largimin tij nga territori nëpërmjet provës, se ka zbatuar urdhrin e largimit, e cila i bashkëlidhet kërkesës për shfuqizimin e aktit urdhër-largimi, drejtuar institucionit që ka nxjerrë aktin.

3. Autoriteti shtetëror përgjegjës vendor për trajtimin e të huajve, krahas nxjerrjes së urdhrin të largimit për të huajin me qëndrim të parregullt në territor, vendos gjobë si ndaj të huajt subjekt largimi ashtu dhe ndaj personave publikë, juridikë ose fizikë, vendës apo të huaj, sipas përcaktimeve në nenin 141, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”. I gjithë informacioni hidhet në Regjistrin Kombëtar Elektronik për të Huajt (moduli “Të huajt e parregullt”) dhe pasqyrohet në komunikatën ditore të punës.

4. Pas nxjerrjes së urdhrin të largimit, struktura përgjegjëse pranë autoritetit shtetëror përgjegjës vendor për trajtimin e të huajve, ndjek zbatimin e detyrimeve që parashikohen në akt.

5. Autoriteti shtetëror qendror përgjegjës vendor për trajtimin e të huajve, pas përzgjedhjes së të huajt si imigrant i parregullt, nëse konstaton se përmbushen kushtet e nenit 102, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, nxjerr urdhrin e dëbimit për të huajin, sipas modelit në aneksin 6 të këtij udhëzimi dhe i komunikon të huajt në gjuhën që kupton, ose së paku në gjuhën angleze, urdhrin e dëbimit, si dhe detyrimet që rrjedhin nga ky akt. Një kopje e urdhrin të dëbimit të nxjerrë nga autoriteti vendor për kufirin dhe migracionin, së bashku me një kopje të praktikës së ndjekur, dërgohet për njohje, brenda 7 ditëve pune nga nxjerrja e tij, pranë autoritetit shtetëror qendror përgjegjës për trajtimin e të huajve.

6. I huaji, subjekt dëbimi, bazuar në vlerësimin rast pas rasti, ndalohet në Qendrën e Mbyllur ose urdhërohet të zbatojë një ose disa nga masat



alternative të parashikuara në ligjin nr. 79/2021, “Për të huajt”.

7. Ministri i Brendshëm, në bazë të propozimit të autoriteteve përgjegjëse për trajtimin e të huajve, nxjerr urdhrin e dëbimit për të huajin e shpallur si person i padëshiruar, sipas modelit të përcaktuar në aneksin 7 të këtij udhëzimi dhe nëpërmjet autoritetit shtetëror qendror përgjegjës për trajtimin e të huajve, informon të huajin mbi aktin e nxjerrë. Autoriteti shtetëror përgjegjës në nivel vendor për trajtimin e të huajve, pasi njoftohet zyrtarisht nga autoriteti shtetëror qendror përgjegjës për trajtimin e të huajve, ekzekuton urdhrin e dëbimit të nxjerrë nga ministri i Brendshëm, duke u bazuar në kërkesat e nenit 106, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”.

8. Në rastin kur azilkërkuesit i refuzohet statusi i azilit apo heq dorë nga mbrojtja ndërkombëtare, autoriteti shtetëror qendror përgjegjës për trajtimin e të huajve, pas njoftimit nga ana e autoritetit shtetëror përgjegjës për trajtimin e azilkërkuesve dhe refugjatëve dhe kur nuk ekziston mundësia e largimit (që ekzekutohet vullnetarisht) me mjetet vetjake financiare, ndërmerr nisma për kthimin e të huajit në vendin e origjinës apo vendin ku pranohet, duke i dhënë përparësi kthimit vullnetar apo kthimit vullnetar të asistuar.

V. KOMISIONI I SHQYRTIMIT TË ANKESAVE

1. Pranë autoritetit shtetëror qendror përgjegjës për trajtimin e të huajve krijohet Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave. Ky autoritet përcakton numrin dhe funksionet e anëtarëve të Komisionit nga radhët e tij. Përfaqësimi në këtë Komision mund të shkojë deri në 5 anëtarë por jo më pak se 3 anëtarë. Përbërja e Komisionit ripërtërihet çdo 1 (një) vit.

2. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave është përgjegjës për trajtimin e të gjitha ankesave administrative drejtuar autoritetit shtetëror qendror përgjegjës për trajtimin e të huajve, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 79/2021, “Për të huajt”.

VI. KTHIMI VULLNETAR I ASISTUAR

1. Kur shtetasi i huaj i parregullt, shpreh vullnetin e tij për t’u kthyer në vendin e origjinës apo në vendin ku pranohet, autoriteti shtetëror qendror përgjegjës për trajtimin e të huajve, bazuar mbi informacionin e autoritetit përgjegjës vendor për trajtimin e të huajve apo autoritetit të Qendrës së Mbyllur, ku shprehet qartësisht vullneti për t’u

kthyer, merr masa për të mundësuar kthimin vullnetar të tij.

2. Pas njoftimit zyrtar nga e autoritetit përgjegjës vendor për trajtimin e të huajve apo autoritetit të Qendrës së Mbyllur, autoriteti shtetëror qendror përgjegjës për trajtimin e të huajve merr masa duke kërkuar zyrtarisht asistencën e IOM-it për të mundësuar kthimin vullnetar të asistuar të shtetasit të huaj në vendin e origjinës apo në vendin ku pranohet.

3. Në kuadrin e trajtimit të kërkesës nga IOM-i, autoriteti përgjegjës vendor për trajtimin e të huajve apo autoriteti i Qendrës së Mbyllur, mban kontakte me IOM-in dhe asiston atë në çdo hap të procedurës së trajtimit të kërkesës për kthim vullnetar të asistuar.

4. Autoriteti shtetëror qendror përgjegjës për trajtimin e të huajve, pasi IOM-i ka finalizuar procesin e kthimit vullnetar të asistuar (është siguruar dokumenti i udhëtimit, bileta e kthimit), si dhe pasi është njoftuar zyrtarisht (me postë dhe/ose me *email*) nga IOM-i, lidhur me detajet e udhëtimit të shtetasit subjekt i kthimit vullnetar të asistuar, e përcjell atë pranë Pikës së Kalimit Kufitar, duke kërkuar ofrimin e asistencës për lehtësimin procedural të daljes nga territori. Shtetasi, subjekt i kthimit vullnetar të asistuar, nuk i nënshtrohet një penaliteti administrativ apo financiar në dalje nga territori.

VII. PROCEDURA E EKZEKUTIMIT TË GJOBËS

1. Autoriteti përgjegjës vendor për trajtimin e të huajve, sipas përcaktimeve në Kodin e Procedurës Administrative, kryen ekzekutimin forcërisht të gjobës së venë ndaj të huajit apo subjekteve, nëse gjoba nuk është ekzekutuar vullnetarisht nga ana e tyre brenda afatit 1 muaj nga data e komunikimit të gjobës.

2. Sipas përcaktimeve në nenin 133, pika 2, të Kodit të Procedurave Administrative, në rast se gjoba nuk është ekzekutuar në mënyrë vullnetare, autoriteti shtetëror përgjegjës në nivel vendor për trajtimin e të huajve, 30 ditë pas komunikimit të gjobës, njofton me shkrim të huajin ose subjektin për ekzekutimin e menjëhershëm me forcë të gjobës dhe fillon ekzekutimin e saj të menjëhershëm, sipas Kodit të Procedurës Civile.

3. Autoriteti shtetëror përgjegjës në nivel vendor për trajtimin e të huajve, në rastet kur ka kundërshtime gjatë ekzekutimit të gjobës, ndjek



rrugën ligjore për ekzekutimin e titullit ekzekutiv (gjobës).

VIII. PROCEDURA E NXJERRJES DHE E EKZEKUTIMIT TË MASAVE TË PÛRKOHSHME

1. Autoriteti shtetëror përgjegjës në nivel vendor për trajtimin e të huajve, aplikon një ose disa masa të përkohshme alternative të ndalimit në Qendrën e Mbyllur të të huajt, subjekt dëbimi, në bazë të vlerësimit rast pas rasti. Ky autoritet, bazuar në kërkesën e drejtpërdrejtë të një subjekti fizik apo juridik, institucioni apo përfaqësie të huaj të akredituar në Shqipëri apo të një kërkesë të përcjellë nga autoriteti shtetëror qendror përgjegjës për kufirin dhe migracionin, kur e vlerëson të nevojshme, mund të zëvendësojë masën e ndalimit në Qendrën e Mbyllur, edhe pasi kjo e fundit është ekzekutuar, me masën “detyrim paraqitjeje”. Autoriteti i sipërpërmendur, në rastin e vlerësimit pozitiv të kërkesës, informon Qendrën e Mbyllur dhe vë në dijeni autoritetin shtetëror qendror përgjegjës për kufirin dhe migracionin. Autoriteti vendor për kufirin dhe migracionin kërkon paraqitjen e shtetasit të huaj, të cilit i është zëvendësuar masa e ndalimit me masën “detyrim paraqitjeje”, në intervale të rregullta kohore deri në largimin e tij nga territori.

2. Autoriteti shtetëror përgjegjës në nivel vendor për trajtimin e të huajve mund ta ndalojë të huajin në Qendër të Mbyllur, vetëm duke nxjerrë “urdhër ndalimi” (ndalimi në Qendër nuk vjen si pasojë e masës administrative “urdhër dëbimi”) për arsye të sigurisë publike, identiteti apo arsyet e qëndrimit të të cilit nuk janë të qarta. Duke vlerësuar situatën në raport me ecurinë e rastit, autoriteti shtetëror përgjegjës vendor për trajtimin e të huajve, mund të lëshojë në vazhdim “urdhër dëbimi”.

3. Vlerësimi i aplikimit të masave të përkohshme alternative, bëhet në bazë të rrezikshmërisë së personit ndaj rendit dhe sigurisë publike, rrezikshmërisë së fshehjes ndaj autoriteteve të kufirit dhe migracionit, të largimit të paligjshëm drejt një vendi tjetër, si dhe të rrethanave në të cilat është nxjerrë urdhri i dëbimit. Interesi më i lartë i fëmijës dhe i ruajtjes së bashkimit të familjes merren gjithmonë në konsideratë.

4. Autoriteti shtetëror përgjegjës vendor për trajtimin e të huajve, njofton të huajin për masën e përkohshme apo masat e përkohshme të marra

ndaj tij, me anë të urdhrit të nxjerrë, sipas modeleve në anekset e këtij udhëzimi. Urdhri për ekzekutimin e masës së përkohshme ndaj të huajt subjekt dëbimi, hidhet menjëherë në Regjistrin Elektronik Kombëtar për të Huajt (moduli “Të huajt e parregullt”).

5. Autoriteti shtetëror përgjegjës vendor për trajtimin e të huajve është përgjegjës për monitorimin e zbatimit të masave të përkohshme nga i huaji dhe në rast se gjatë ekzekutimit të këtyre masave konstaton se kanë ndryshuar kushtet dhe rrethanat në të cilat është nxjerrë ky urdhër, mund të vendosë për zëvendësimin e këtij urdhri me atë të ndalimit në Qendrën e Mbyllur.

6. Autoriteti i Qendrës së Mbyllur, gjatë kohës së ndalimit të të huajt në këtë Qendër, shqyrton rast pas rasti, kriteret për mundësinë e zëvendësimit të masës së ndalimit në Qendër, me atë të masave të përkohshme dhe i propozon autoritetit qendror shtetëror përgjegjës për trajtimin e të huajve, zëvendësimin e masës së ndalimit në Qendrën e Mbyllur me atë të masave të përkohshme alternative, duke vënë në dijeni për çdo rast autoritetin shtetëror qendror përgjegjës për trajtimin e të huajve.

7. Autoriteti i Qendrës së Mbyllur, gjatë kohës së ndalimit të të huajt në këtë Qendër, pasi vlerëson situatën e rastit, mund t’i propozojë autoritetit shtetëror përgjegjës vendor për trajtimin e të huajve, konvertimin e masës administrative “urdhër dëbimi” me atë të masës administrative “urdhër largimi” (për t’u ekzekutuar vullnetarisht), duke vënë në dijeni për çdo rast autoritetin shtetëror qendror përgjegjës për trajtimin e të huajve.

8. Autoriteti shtetëror përgjegjës vendor për trajtimin e të huajve shqyrton brenda 10 ditëve propozimin e autoritetit të Qendrës së Mbyllur për mundësinë e zëvendësimit të masës së ndalimit me një masë tjetër alternative apo konvertimit të masës së dëbimit me atë të masës së largimit (për t’u ekzekutuar vullnetarisht) dhe në bazë të rrezikshmërisë që paraqet subjekti në raport me rendin dhe sigurinë publike, rrezikshmërisë së fshehjes ndaj autoriteteve të kufirit dhe migracionit, si dhe të rrethanave në të cilat është nxjerrë masa administrative e dëbimit, vendos miratimin ose refuzimin e propozimit/kërkesës, duke vënë në dijeni për çdo rast autoritetin shtetëror qendror përgjegjës për trajtimin e të huajve.



9. Në rast të miratimit të propozimit/kërkesës, autoriteti përgjegjës vendor për trajtimin e të huajve përcakton masën e përkohshme alternative dhe mënyrën e ekzekutimit të saj. Vendimi për zëvendësimin apo për konvertimin e masës administrative me masa të tjera të parashikuara, hidhet në Regjistrin Elektronik Kombëtar për të Huajt (moduli “Të huajt e parregullt”) nga autoriteti shtetëror përgjegjës vendor për trajtimin e të huajve, i cili përcakton dhe ekzekuton masën e zëvendësuar apo të konvertuar.

10. Në rast se brenda afatit kohor maksimal (deri në 1 vit), i përcaktuar në ligjin nr. 79/2021, “Për të huajt” nuk bëhet i mundur largimi i të huajit, atëherë autoriteti shtetëror përgjegjës vendor për trajtimin e të huajve që ka nxjerrë urdhrin e dëbimit dhe/ose urdhrin e ndalimit të të huajit në Qendrën e Mbyllur, pasi është informuar në kohë nga Qendra e Mbyllur për rastin, 15 ditë para mbarimit të afatit maksimal të ndalimit, i propozon autoritetit qendror shtetëror përgjegjës për trajtimin e të huajve zëvendësimin e masës së ndalimit në Qendrën e Mbyllur me atë të detyrimit të qëndrimit në një territor të caktuar. Pas miratimit të kërkesës nga ana e autoritetit qendror shtetëror përgjegjës për trajtimin e të huajve, autoriteti shtetëror përgjegjës vendor për trajtimin e të huajve, me qëllim nxjerrjen e urdhrin të qëndrimit të detyrueshëm në një territor të caktuar, sipas modelit të përcaktuar në aneksin nr. 8 të këtij udhëzimi, njofton dhe pajis të huajin me një kopje të urdhrin, si dhe bën shënimet e duhura në Regjistrin Kombëtar Elektronik për të Huajt (moduli “Të huajt e parregullt”).

11. Në rast se ekzistojnë kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 79/2021, “Për të huajt” dhe në këtë udhëzim, si dhe kur gjykohet në bazë të vlerësimit, rast pas rasti, autoriteti shtetëror përgjegjës vendor për trajtimin e të huajve, mund të marrë ndaj të huajit masën e përkohshme “detyrim paraqitjeje”, sipas formatit të miratuar në aneksin 9 të këtij udhëzimi. Paraqitja nuk mund të jetë më shumë se një herë në ditë dhe më pak se një herë në javë. Orari i paraqitjes duhet të përcaktohet brenda orarit zyrtar të punës.

12. Në rast se ekzistojnë kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 79/2021, “Për të huajt”, si dhe në këtë udhëzim, si dhe kur gjykohet në bazë të vlerësimit, rast pas rasti, autoriteti shtetëror përgjegjës vendor për trajtimin e të huajve, mund të marrë ndaj të

huajit masën e përkohshme të bllokimit të dokumentit të udhëtimit, si dhe të biletës së udhëtimit, nëse i disponon, përkundrejt një procesverbali bllokimi, i cili mbahet në dy kopje dhe një kopje i jepet të interesuarit. Masa e përkohshme e bllokimit të dokumentit të udhëtimit, si dhe të biletës së udhëtimit, ndaj të huajit subjekt largim/dëbimi mund të merret kur ndaj tij është marrë një masë tjetër e përkohshme ose ajo e detyrimit për paraqitje ose ajo e detyrimit të qëndrimit në një territor të caktuar. Në rast të bllokimit të dokumentit të udhëtimit, i huaji subjekt i kësaj mase, pajiset nga autoriteti shtetëror përgjegjës vendor për trajtimin e të huajve me një dokument identifikimi, sipas modelit të përcaktuar në aneksin nr. 10 të këtij udhëzimi.

13. Në rast se ekzistojnë kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 79/2021, “Për të huajt” dhe në këtë udhëzim, si dhe kur gjykohet në bazë të vlerësimit rast pas rasti, autoriteti shtetëror përgjegjës vendor për trajtimin e të huajve, mund të marrë ndaj të huajit masën e përkohshme të bllokimit të mjeteve financiare që i gjenden në momentin e nxjerrjes së urdhrin të largim/dëbimit ose mund t’i gjenden në vazhdimësi deri në largim/dëbimin e tij nga territori. Bllokimi i mjeteve financiare bëhet kundrejt një procesverbali, i cili mbahet në dy kopje, njëra nga të cilat i jepet të interesuarit. Mjetet financiare të bllokuara përdoren në bazë të një urdhrin të autoritetit shtetëror përgjegjës vendor për trajtimin e të huajve, për të mbuluar shpenzimet e kthimit të të huajit, subjekt i bllokimit të këtyre mjeteve. Mjetet financiare të bllokuara mbahen në strukturën e financës së autoritetit shtetëror përgjegjës vendor për trajtimin e të huajve. Pjesa e mbetur nga mjetet financiare të bllokuara pas mbulimit të shpenzimeve të udhëtimit, i kthehen të huajit në momentin e largimit nga territori, kundrejt një procesverbali dorëzimi, i cili mbahet në dy kopje, njëra nga të cilat i jepet të interesuarit.

14. Në vend të masave të tjera të përkohshme ose në mënyrë të kombinuar me to, sipas vlerësimit, rast pas rasti, autoriteti shtetëror përgjegjës vendor për trajtimin e të huajve mund t’i kërkojë të huajit të vendosë një garanci financiare në numrin e llogarisë së tij deri në atë masë që mund të garantojë kthimin e tij/saj. Garancia financiare e të huajit lirohet nga autoriteti shtetëror përgjegjës vendor për trajtimin e të huajve, atëherë



kur është garantuar mbulimi i shpenzimeve të kthimit të të huajt.

IX. PROCEDURA E NDALIMIT NË QENDRËN E MBYLLUR

1. Autoriteti shtetëror përgjegjës vendor për trajtimin e të huajve, sipas parashikimeve të nenit 115, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, ndërmerr dhe ekzekuton masën administrative për ndalimin në Qendrën e Mbyllur, duke nxjerrë për këtë urdhrin e ndalimit në Qendrën e Mbyllur, sipas modelit në aneksin nr. 11 të këtij udhëzimi.

2. Transferimi i imigrantëve të parregullt në Qendrën e Mbyllur bëhet duke përdorur mjetet e transportit dhe forcat që ka në dispozicion autoriteti shtetëror përgjegjës vendor për trajtimin e të huajve në juridiksionin territorial të të cilit ata gjenden me qëndrim të parregullt apo kanë përfunduar vuajtjen e dënimit penal.

3. Autoriteti shtetëror përgjegjës vendor për trajtimin e të huajve informon paraprakisht, para nisjes, autoritetin e Qendrës së Mbyllur, lidhur me transferimin në këtë Qendër të të huajt, me qëllim marrjen e masave të nevojshme për akomodimin e tyre në Qendër.

4. Struktura përgjegjëse pranë autoritetit shtetëror përgjegjës vendor për trajtimin e të huajve, hedh informacionin përkatës në Regjistrin Kombëtar Elektronik për të Huajt (moduli “Të huajt e parregullt”), para transferimit të të huajt për në Qendrën e Mbyllur.

5. Autoriteti shtetëror përgjegjës vendor për trajtimin e të huajve dorëzon të huajin, subjekt i ndalimit, si pasojë e nxjerrjes së urdhrit të dëbimit në Qendrën e Mbyllur, së bashku me dokumentacionin/provat që vërtetojnë/prezumojnë shtetësinë e të huajt dhe që shërbejnë për fillimin e procedurave të kthimit/ripranimit.

6. Autoriteti shtetëror përgjegjës vendor për trajtimin e të huajve bashkëpunon me autoritetin e Qendrës së Mbyllur, sipas përcaktimeve në nenin 122, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, për të siguruar mjetet financiare për të mbuluar koston e qëndrimit në Qendër, si dhe shpenzimet e tjera për largimin/dëbimin e tij. Depozitimi dhe përdorimi i mjeteve financiare, sipas përcaktimeve në nenin 122, bëhen në bazë të një urdhri të brendshëm të miratuar nga autoriteti i Qendrës së Mbyllur.

7. Autoriteti i Qendrës së Mbyllur, dërgon zyrtarisht pranë autoritetit shtetëror qendror përgjegjës për trajtimin e të huajve dokumenta-

cionin/provat që vërtetojnë/prezumojnë shtetësinë e të huajt dhe që shërbejnë për fillimin e procedurave të kthimit/ripranimit. Autoriteti shtetëror qendror përgjegjës për trajtimin e të huajve, pasi shqyrton dokumentacionin e dërguar, fillon procedurat e kthimit/ripranimit të të huajt, në vendin e tranzitit, rezidencës apo të origjinës.

X. ZGJATJA E AFATIT TË QËNDRIMIT NË QENDRËN E MBYLLUR

1. Nëse ndalimi ka zgjatur 6 (gjashtë) muaj dhe nuk është bërë i mundur kthimi i të huajt subjekt ndalimi në Qendër, autoriteti i Qendrës së Mbyllur, sipas përcaktimeve në nenin 117, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, i propozon autoritetit qendror shtetëror përgjegjës për trajtimin e të huajve periudhën e zgjatjes së afatit të ndalimit në Qendër.

2. Autoriteti qendror shtetëror përgjegjës për trajtimin e të huajve, pasi shqyrton kërkesën për zgjatje të afatit të qëndrimit në Qendër, njofton autoritetin e Qendrës së Mbyllur për vendimin e marrë brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesës.

3. Në rast se autoriteti qendror shtetëror përgjegjës për trajtimin e të huajve refuzon zgjatjen e afatit të qëndrimit në Qendrën e Mbyllur, autoriteti i Qendrës së Mbyllur bën shënimet në Regjistrin Kombëtar Elektronik për të huajt. Në këtë rast, autoriteti shtetëror përgjegjës vendor për trajtimin e të huajve, pasi njoftohet nga autoriteti qendror shtetëror përgjegjës për trajtimin e të huajve për refuzimin, bashkëpunon me autoritetin e Qendrës së Mbyllur për daljen nga Qendra dhe marrjen e masave përkatëse.

4. Autoriteti i Qendrës së Mbyllur, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse pranë autoritetit qendror për kufirin dhe migracionin, përgatit kthimin/ripranimin e të huajt në vendin e tranzitit, rezidencës apo të origjinës.

5. Përgjegjësi i eskortës së shoqërimit të të huajt subjekt dëbimi bashkëpunon me autoritetin e pikës së kalimit kufitar për daljen e të huajt subjekt kthimi nga territori. Autoriteti në pikën e kalimit kufitar kryen procedurën e regjistrimit të të huajt në dalje në sistemin e kontrollit kufitar, si dhe asiston eskortën gjatë procesit të dorëzimit të subjektit në pikën e kalimit kufitar të shtetit ku është përcaktuar kthimi. Në çdo rast, procedura e kthimit përfundon me plotësimin e aktit të dorëzimit, si dhe nënshkrimin e tij nga autoritetet që pranojnë të huajin subjekt kthimi.



XI. PROCEDURA PËR RIPRANIMIN E TË HUAJVE NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

1. Autoriteti shtetëror qendror përgjegjës për trajtimin e të huajve, në bazë të detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet e ripranimit të Republikës së Shqipërisë me shtetet e tjera, kryen procedurën e ripranimit të shtetasve të vendeve të treta apo të personave pa shtetësi, të cilët kanë përdorur territorin e Republikës së Shqipërisë, si vend tranzit për të kaluar në këto vende.

2. Në rast të kërkesave për ripranim nga ana e shteteve me të cilat Republika e Shqipërisë ka nënshkruar marrëveshje ripranimi, autoriteti shtetëror qendror përgjegjës për trajtimin e të huajve që merr kërkesën, vlerëson provat apo provat në dukje që provojnë se i huaji i cili kërkohet të ripranohet ka përdorur territorin e Republikës së Shqipërisë për të kaluar në mënyrë të paligjshme në këto vende dhe i kthen përgjigjen palës kërkuese.

3. Në rast se pranohet kërkesa për ripranim, atëherë ky autoritet informon palën kërkuese për datën, orën dhe pikën e kalimit kufitar ku do të dorëzohet i huaji subjekt ripranimi, e njofton autoritetin shtetëror përgjegjës vendor për trajtimin e të huajve dhe PKK-në përkatëse në juridiksionin territorial të tij për marrjen e masave për pritje. Autoriteti shtetëror përgjegjës vendor për trajtimin e të huajve informon me telefon ose me *email* personelin e Qendrës së Mbyllur për marrjen e masave për akomodimin në Qendër.

4. Shërbimet e policisë kufitare dhe të migracionit në pikën e kalimit kufitar ku kryhet ripranimi, kryejnë procedurën e përzgjedhjes së të huajit, sipas formularit në aneksin nr. 3 të këtij udhëzimi, duke e klasifikuar atë si imigrant të parregullt, bëjnë regjistrimin e tij “Hyrje” në sistemin TIMS, si dhe hedhin informacionin në Regjistrin Kombëtar Elektronik për të Huajt (moduli “Të huajt e parregullt”).

5. Sipas specifikave të përcaktuara në kërkesat për ripranim, autoriteti qendror shtetëror përgjegjës për trajtimin e të huajve në bashkëpunim me autoritetin shtetëror përgjegjës vendor për trajtimin e të huajve në territorin e të cilit kryhet ripranimi, marrin masa për të siguruar gjithë asistencën e nevojshme mjekësore, pranimë e punonjësit social apo të psikologut në pikën e kalimit kufitar ku kryhet ripranimi, si dhe gjatë transportit të të huajit

subjekt ripranimi për në Qendrën e Mbyllur apo në territorin e caktuar ku do të zbatohet masa alternative.

6. Pas kryerjes së procedurës së përzgjedhjes dhe klasifikimit të të huajit të ripranuar si “imigrant i parregullt”, autoriteti shtetëror përgjegjës vendor për trajtimin e të huajve në territorin e të cilit kryhet ripranimi, nxjerr për të huajin subjekt ripranimi urdhrin e dëbimit dhe atë të ndalimit në Qendrën e Mbyllur ose urdhrin e zbatimit të masave alternative, bazuar në vlerësimin rast pas rasti, si dhe kryen transportin e të huajit subjekt ripranimi në Qendrën e Mbyllur për të Huajt ose në vendin ku do të ekzekutohet urdhri i zbatimit të masës/ave alternative.

7. Në rast të kthimit pa kërkesë apo njoftim paraprak të shtetasve të vendeve të treta, autoritetet për kufirin dhe migracionin, në pikën e kalimit kufitar ku kryhet kthimi, njoftojnë, nëpërmjet autoritetit shtetëror përgjegjës vendor, autoritetin shtetëror qendror përgjegjës për trajtimin e të huajve mbi të huajin e kthyer, së bashku me provat apo provat në dukje (nëse disponohen), që provojnë se i huaji i kthyer në pikën e kalimit kufitar ka përdorur territorin e Republikës së Shqipërisë për të kaluar në mënyrë të paligjshme në këto vende dhe nuk pranojnë hyrjen në territor të shtetasit të kthyer pa konfirmimin e tij. Autoriteti shtetëror qendror përgjegjës për trajtimin e të huajve, pasi analizon provat apo provat në dukje, merr një vendim për pranimin ose jo në territorin e Republikës së Shqipërisë të të huajit të kthyer (shtetas i vendeve të treta) në pikën e kalimit kufitar dhe këtë vendim ia komunikon autoritetit shtetëror përgjegjës vendor për trajtimin e të huajve.

8. Në rast se autoriteti shtetëror qendror përgjegjës për trajtimin e të huajve merr vendim për pranimin e shtetasit të huaj subjekt kthimi (referuar pikës 7, kapitulli XI), atëherë autoriteti shtetëror përgjegjës vendor për trajtimin e të huajve kryen të njëjtat procedura si ato të përcaktuara në pikën 5, kapitulli XII të këtij udhëzimi.

9. Në rast se autoriteti shtetëror qendror përgjegjës për trajtimin e të huajve merr vendim për mospranimin e shtetasit të huaj subjekt kthimi, njofton autoritetin shtetëror përgjegjës vendor për trajtimin e të huajve. Shërbimet e policisë kufitare dhe të migracionit në pikën e kalimit kufitar ku është kërkuar kthimi i të huajit, mbi bazën e



vendimit për mospranim, kryejnë procedurat e refuzimit të hyrjes në kufi.

XII. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Me zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

2. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi

ANEKSI NR. 1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
Departamenti për Kufirin dhe Migracionin
Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin _____
Pika e Kalimit Kufitar _____

REFUZIM I HYRJES NË KUFË - REFUSAL OF ENTRY AT THE BORDER

Më datë (On)..... Rinas, ora (at), në Pikën e Kalimit Kufitar (at the border crossing point), ne të nënshkruarit punonjës të PKM, të PKK (we the undersigned, BAP officers of BCP) Inspektor, Nënkomisare, kemi përballë nesh (have before us):

Emri (First name) _____, Mbiemri (Surname) _____, Datëlindja (Date of birth) _____
Vendlindja (Place of birth) _____, Gjinia (Sex) _____, Shtetësia (Nationality) _____, Banues në
(Resident in) _____, me dokumentin tip (Type of identity document) _____, me numër
(number) _____, lëshuar në (Issued in) _____, më (on) _____, me vizë nr.
(Visa/number) _____, tip (type) _____, lëshuar nga (issued by) _____,
e vlefshme nga (valid from) _____ deri më (until) _____, për një periudhë (for a period of) _____ ditësh
(days), për arsye (on the following grounds): _____, i cili / e cila ka ardhur nga (coming from) _____
by (means of) _____, është informuar se i është refuzuar hyrja në bazë të Ligjit nr.
79/2021, Neni 9 i tij, (he/she is hereby informed that he/she is refused entry into the country pursuant to Law no. 79/2021), për
arsyet e mëposhtme (for the following reasons):

☐ (A) nuk disponon dokument/e të vlefshëm udhëtimi (has no valid travel document/s)

☐ (B) disponon dokument të falsifikuar/me ndërhyrje/të manipuluar (has a false/counterfeit/forged travel document and/or residence permit).

☐ (C) nuk disponon vizë ose leje qëndrimi të vlefshme (has no valid visa or residence permit)

☐ (D) disponon vizë ose leje qëndrimi të falsifikuar/me ndërhyrje/të manipuluar (has a false/counterfeit/forged visa or residence permit)

☐ (E) nuk disponon dokumentacionin e nevojshëm që justifikon qëllimin e udhëtimit dhe qëndrimit (has no appropriate documentation justifying the purpose and conditions of stay)
nuk u paraqitën dokumentet e mëposhtme: (The following document(s) could not be provided): _____

☐ (F) ka plotësuar periudhën e qëndrimit prej 90 ditësh në 6 muaj në territorin e Republikës së Shqipërisë (has already stayed for three months during a 6-month period on the territory of the Republic of Albania)

☐ (G) nuk disponon mjetet e mjaftueshme të jetesës në lidhje me kohën dhe rrethanat e qëndrimit dhe mjetet e kthimit në vendin e origjinës ose të tranzitit (does not have sufficient means of subsistence in relation to the period and form of stay, or the means to return to the country of origin or transit)

☐ (H) është person për të cilin ka një shënim që i refuzohet hyrja (is a person for whom an alert has been issued for the purposes of refusing entry)

☐ (I) konsiderohet si kërcënim për sigurinë publike, sigurinë e brendshme, shëndetin publik ose marrëdhëniet ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë (considered to be a threat to public policy, internal security, public health or the international relations of the Republic of Albania)(each State must indicate the references to national law relating to such cases of refusal of entry).

Shënime (Comments): Personi i refuzuar mund të apelojë kundër këtij vendimi sipas parashikimeve të legjislacionit të kombëtar [Nr.8485 KPA & Nr.8116 KPC]. Personit të refuzuar i jepet një kopje e këtij dokumenti. (The person concerned may appeal against the decision to refuse entry as provided for in national law [Nr.8485 APL & Nr.8116 CPL]. The person concerned receives a copy of this document)


Personi i refuzuar (Person concerned) _____

Punonjësi i PKM (Officer responsible for checks)
P. Turni
Roje Kufitare Inspektore.



ANEKS 2

REFUZIMI I HYRJES





ANEKSI NR. 3

FORMULAR I PERZGJEHDJES
TË SHTETASVE TË HUAJ TË PARREGULLT
PRE-SCREENING FORM
FOR THE IRREGULAR FOREIGN NATIONALS

Emri i plotë: Gjinia: M ☐ F ☐

Full name: Sex: M ☐ F ☐

☐ أنثى ☐ ذكر الجنس: الاسم الكامل:

Datëlindja (Data/Muaji/Viti)

Date of birth (Date/Month/Year)

..... تاريخ الميلاد (التاريخ/الشهر/السنة):

Vendlindja (Fshati/Qyteti/Shteti):

Place of birth (Village/Town/Country):

..... مكان الميلاد (القرية/المدينة/المحافظة/الدولة):

Dokumenti i identifikimit: Data e skadimit:/...../.....

Identity Document in possession: Expiration date:/...../.....

..... تاريخ الصلاحية: ثبات الهوية (جواز سفر/بطاقة إثبات شخصية غ:

Besimi fetar: Kombësia: Shtetësia:

Religion: Nationality: Citizenship:

..... الديانة: القومية (النسبة العرقية): الجنسية:

Data e hyrjes në Shqipëri:/...../..... Vendi ose PKK i hyrjes në Shqipëri:

Entry date in Albania:/...../..... Place or Border Crossing Point in Albania:

..... تاريخ الدخول في ألبانيا:/...../.....

..... اسم المكان/ الموقع الحدودي الذي تم الدخول في ألبانيا عبره:

Vendi i konstatimit / kapjes në territor nëse ndryshon nga vendi i hyrjes:

Place of capture / ascertaining if different from the border crossing point:

..... اسم المكان الذي تم القبض عليه إذا كان مختلفا عما في الأعلى (أي غير نقطة تفتيش حدودية):



ANEKSI NR. 3

Profesioni: Arsimimi: Gjendja shëndetësore:

Profession: Education: Health's condition:

المهنة: التعليم: الحالة الصحية (معاق/سليم):

Puna që keni kryer në vendin e origjinës/ vendi punës/ periudha kohore:

The job you did at home country/ type and place of work/time/period:

مكان و نوع العمل/المنصب الذي قمت به سابقا في بلد الأصل/الفترة:

.....

.....

.....

Familjarë që shoqërojnë të intervistuarin:

Family members accompanying the interviewee:

المرافقون بالشخص الذي تتم مقابلته (ذوي القربى / أعضاء الأسرة):

Nr. No.	Emri i plotë Full name	Datëlindja Date of birth	Vendlindja Place of birth	Lidhja familjare Relationship

ق	الاسم بالكامل	تاريخ الميلاد	مكان الميلاد	الصلة

Aftësi / njohuri / eksperiencë të veçanta / gjuhë të huaja:

Special skills /talents /expertise /Foreign Languages:

مهارات أو معارف أو خبرات خاصة بالمتقدم / معرفة اللغات الأجنبية :

Itinerari prej ditës së nisjes nga vendi origjinës, shtetet e tranzitit dhe periudha e qëndrimit atje:

Itinerary from departure date from the home country, transited countries and period of stay there:

الرحلة من تاريخ مغادرة بلد الأصل، الدول التي تم المرور من خلالها وفترة/مكان الإقامة بها (اشرح بالتفصيل):

.....



ANEKSI NR. 3

.....

Arsyet e largimit nga vendi i origjinës/ Reasons for leaving the home country:

أسباب الهجرة/مغادرة بلد الأصل:

.....

A keni kërkuar azil në vende të tjera?

Po



Have you applied for asylum in other countries?

Yes



No



لا



نعم



هل سبق أن تقدمت للحصول على حق اللجوء في دول أخرى؟

Nëse po, në cilin vend keni kërkuar azil?

If yes, in which country?

..... إذا كان الجواب نعم، في أية دولة؟

Cili është destinacioni juaj final?

Which is your final destination?

..... (hapësira për gjuhën arabe)

A do të kërkonit mbrojtje në Republikën e Shqipërisë?

Po

Jo

Would you ask for protection in the Republic of Albania

Yes

No

لا

نعم

هل سبق أن تقدمت للحصول على حق اللجوء في دول أخرى؟

Dëshironi të ktheheni në vendin tuaj?

Po



Jo



Do you want to return in your home country?

Yes



No



لا



نعم

هل تريد العودة في بلدك؟

Dëshironi asistencën e organizatës IOM për t'u kthyer vullnetarisht në vendin e origjinës:



Jo

Do you want the IOM's assistance to be repatriated voluntarily:



Jes



No



لا



نعم

هل تريد مساعدة المنظمة الدولية للهجرة للعودة تطوعياً في بلدك:



ANEKSI NR. 3

Të dhëna të tjera / Other personal data / بيانات شخصية أخرى :

Numri telefonit/celularit në vendin e origjinës/ në Shqipëri:

Phone/Mobile number at the home country/ Albania:

Adresa e Email-it/ Facebook/ Skype:

Email address/Facebook/Skype:

رقم الهاتف/الخلوي في بلد الأصل/ في ألبانيا:

عنوان البريد الإلكتروني، فيسبوك أو سكايب:

Intervistuesit /Interviewers:

القائم بالمقابلة:

Aplikanti/ Applicant:

الشخص الذي تمت مقابله:

Përkthyesi/ Translator:

المترجم:

Vendi i intervistës / Interviewing Place:

المكان الذي جرت فيه المقابلة:

Dorëzuar / Handed over:

تم تسليمها:

Date:/...../.....

التاريخ: /



ANEKSI NR. 4

 REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E BRENDSHME Drejtoria Përgjithshme e Policisë së Shtetit Departamenti për Kufirin dhe Migracionin Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Migracionit _____		
PROCESVERBAL DORËZIMI		
Pas përfundimit të procesit të përzgjedhjes, kryer me datë _____, në ambientet e _____, për shtetasin me identitet të vetdeklaruar/të dokumentuar:		
Emri _____	Mbiemri _____	Gjinia _____
Datëlindja _____		Vendlindja _____
Shtetësia _____		Statusi _____
Deklaroj se dorëzoj pranë Autoritetit Përgjegjës _____ shtetasin e huaj të sipërpërmendur		
MARRËSI NË DORËZIM		DORËZUESI
Emër, Mbiemër _____		Emër, Mbiemër _____
Titulli _____		Titulli _____
Vendndodhja _____		Vendndodhja _____
Data _____		Data _____



ANEKSI NR. 5


 REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E BRENDSHME

 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
 DEPARTAMENTI PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN
 DREJTORIA VENDORE PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN _____

 URDHËR LARGIMI
 REMOVAL ORDER

 Nr _____, Datë _____
 No _____, Date _____

 Për largimin nga territori i Republikës së Shqipërisë të një shtetasi:
On the removal from the territory of the Republic of Albania of a citizen:

 URDHËROJ
 I ORDER

 1. Largimin nga territori i Republikës së Shqipërisë, të shtetasit:
On the removal from the territory of the Republic of Albania of the citizen as follows:

Mbiemri _____ <i>Family name</i>	Emri _____ <i>First name</i>	
Emri i Babait _____ <i>Father's Name</i>	Emri i nënës _____ <i>Mother's Name</i>	
Datëlindja _____ <i>Date of birth</i>	Vendlindja _____ <i>Place of birth</i>	Gjinia _____ <i>Sex</i>
Shtetësia _____ <i>Citizenship</i>	Banues _____ <i>Resident in</i>	
Dokumenti udhëtimi _____ <i>Travel document no.</i>	Lëshuar në _____ <i>Issued in</i>	datë _____ <i>on</i>

 në mbështetje të Ligjit nr. 79/2021 "Për të huajt", neni 99,pika 1/a,1/b/1/c ,për arsyet në vijim:
based on Law no. 79/2021 "On Aliens", article 99, point 1/a, 1/b/1/c, for the following reasons:
☐ 1/a Nuk plotëson më kushtet e qëndrimit në Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimeve në këtë ligj./ *s/he no longer meets the requirements to stay in the Republic of Albania, in accordance with this law.*
☐ 1/b Ka vuajtur një dënim të dhënë nga gjykatat shqiptare për një krim të kryer me dashje për të cilin Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë parashikon dënim minimal jo më pak se 2 vjet burg./ *s/he has served a sentence ruled by the Albanian courts for having deliberately committed a criminal offence that is punishable with a minimum of two years in prison, according to the Criminal Code of the Republic of Albania.*
☐ 1/c Megjithëse plotëson kushtet e qëndrimit, i huaji punon në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në legjislacionin në fuqi/ *although the alien meets the residence requirements, s/he works contrary to the conditions established by the applicable laws.*

 2. Afati për daljen nga territori jo më shumë se _____ ditë nga data e njoftimit.
Period to leave the territory is not longer than _____ days after being informed.

 3. Shtetasit të mësipërm nuk i lejohet të hyjë në Republikën e Shqipërisë deri datë _____.
The above-mentioned citizen is not allowed to enter into the Republic of Albania until _____.

 4. Kundër këtij Urdhri mund të bëhet ankesë,bazuar në nenin 100 të Ligjit nr. 79/2021 "Për të huajt".
This Order may be appealed based on the Article 100 of Law no.79/2021 "On Aliens".

 5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.
This Order enters into force immediately.

 I larguari: _____
 The removed person
 Mora njoftim Dt. _____ ora _____
 I was informed On. _____ at _____

 DREJTORI
 DIRECTOR



ANEKSI NR. 6



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
DEPARTAMENTI PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN
DREJTORIA VENDORE PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN _____

URDHËR DËBIMI
EXPULSION ORDER

Nr _____, Datë _____
No _____, Date _____

Për dëbimin nga territori i Republikës së Shqipërisë të një shtetasi:
On the expulsion from the territory of the Republic of Albania of a citizen:

URDHËROJ
I ORDER

1. Largimin nga territori i Republikës së Shqipërisë të shtetasit:
On the removal from the territory of the Republic of Albania, of the citizen as follows:

Mbiemri _____ <i>Family name</i>	Emri _____ <i>First name</i>	
Emri i Babait _____ <i>Father's Name</i>	Emri i nënës _____ <i>Mother's Name</i>	
Datëlindja _____ <i>Date of birth</i>	Vendlindja _____ <i>Place of birth</i>	Gjinia _____ <i>Sex</i>
Shtetësia _____ <i>Nationality</i>	Banues _____ <i>Resident in</i>	
Dokumenti udhëtimi _____ <i>Travel document no.</i>	Lëshuar në _____ <i>Issued in</i>	Datë _____ <i>on</i>

në zbatim të Ligjit nr. 79/2021 "Për të huajt", neni 102, pika 1/a, 1/b, 1/c, 1/d, 1/dh, për arsyet në vijim:
based on Law no. 79/2021 "On Aliens", article 102, point 1/a, 1/b, 1/c, 1/d, 1/dh, for the following reasons:

- ☐ a) ka hyrë në mënyrë të paligjshme në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe ka të dhëna se do të përdorë territorin e saj për të kaluar ilegalisht drejt vendeve të tjera/has entered illegally the territory of the Republic of Albania and there are reports that s/he intends to use its territory to cross illegally to other countries;
- ☐ b) nuk është larguar nga Republika e Shqipërisë brenda afateve kohore, të parashikuara në urdhrin e largimit, pa ndonjë arsye objektive, apo pas largimit nga territori dhe brenda afateve të ndalimit të hyrjes rihyn në territorin e Republikës së Shqipërisë/has not left the Republic of Albania within the time limits indicated in the expulsion order with no objective reason or, following departure from the territory, s/he re-enters the territory of the Republic of Albania within the entry ban term;
- ☐ c) nuk është larguar nga territori i Republikës së Shqipërisë deri në 60 ditë pas përfundimit të afatit të qëndrimit të vizës, të lejes së qëndrimit ose afatit të qëndrimit, të parashikuar në këtë ligj për shtetasit që hyjnë pa vizë dhe ka të dhëna se kërkon t'u fshihet autoriteteve të policisë përgjegjëse për kufirin dhe migracionin/ has not left the territory of the Republic of Albania within 60 days following the expiry of the visa validity, residence permit or term of stay foreseen in this law for the nationals who enter visa free and there are indications that they intend to abscond from the police authorities responsible for border and migration;
- ☐ ç) është ripranuar nga një vend tjetër në kuadër të marrëveshjeve të ripranimit në fuqi në Republikën e Shqipërisë/has been readmitted by another country under the applicable readmission agreements with the Republic of Albania;
- ☐ d) është shpallur person i padëshiruar sipas përcaktimeve në nenin 104 të këtij ligji dhe prania e tij në territor konsiderohet si kërcënim serioz për rendin dhe sigurinë publike/has been declared non grata, in accordance with the provisions of Article 104 of this law and his/her presence in the territory is deemed a serious threat to the public order and safety;
- ☐ dh) është dënuar për një krim të kryer me dashje për të cilin legjislacioni shqiptar parashikon një dënim minimal 3 vjet burg/ has been sentenced for a wilful criminal offence that is punishable with a minimum of 3 years in prison, according to the Albanian laws.

2. Afati për daljen nga territori _____ nga data e njohimit.

Period to leave the territory is not longer than _____ days after being informed.

3. Dalja jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të bëhet nëpërmjet PKK _____
Exit from the territory of the Republic of Albania to be carried out through the Border Crossing Point of _____

4. Shtetasit të mësipërm nuk i lejohet të hyjë në Republikën e Shqipërisë deri datë _____
The above-mentioned citizen is not allowed to enter into the territory of the Republic of Albania until _____

5. Kundër këtij urdhri mund të bëhet ankesë, bazuar në nenin 100 të Ligjit nr. 79/2021 "Për të huajt".
This order may be appealed based on Article 100 of Law no. 79/2021 "On Foreigners".

6. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

This Order is effective immediately

I larguari:
The expelled Person _____
Mora njohim Dt. _____ ora _____
I was informed On _____ at _____

DREJTORI
DIRECTOR



ANEKSI NR. 7



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSSHME
MINISTRI

URDHËR DËBIMI
EXPULSION ORDER

Nr _____, Datë _____
No _____, Date _____

Për dëbimin nga territori i Republikës së Shqipërisë të një shtetasi:
On the expulsion from the territory of the Republic of Albania of a citizen:

URDHËROJ
I ORDER

1. Largimin nga territori i Republikës së Shqipërisë të shtetasi si më poshtë:
On the expulsion from the territory of the Republic of Albania of the citizen as follows:

Mbiemri _____ <i>Family name</i>	Emri _____ <i>First name</i>	
Emri i Babait _____ <i>Father's Name</i>	Emri i nënës _____ <i>Mother's Name</i>	
Datëlindja _____ <i>Date of birth</i>	Vendlindja _____ <i>Place of birth</i>	Gjinia _____ <i>Sex</i>
Shtetësia _____ <i>Nationality</i>	Banues _____ <i>Resident in</i>	
Dokumenti udhëtimi _____ <i>Travel document no.</i>	Lëshuar në _____ <i>Issued in</i>	Datë _____ <i>on</i>

në zbatim të Ligjit nr. 79/2021 "Për të huajt", neni 104 ;
based on Law no. 79/2021 "On Foreigners", article 104 ;

Eshtë shpallur "person i padëshirueshëm"
Has been declared "persona non grata"

2. Afati për daljen nga territori _____ nga data e njoftimit.
Period to leave the territory is not longer than _____ days after being informed.

3. Dalja jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të bëhet nëpërmjet PKK _____
Exit from the territory of the Republic of Albania to be carried out through the Border Crossing Point of _____

4. Shteti ku kthehet /pranohet _____
The state of return /state where accepted

5. Shtetasi të mësipërm nuk i lejohet të hyjë në Republikën e Shqipërisë deri datë _____
The above-mentioned citizen is not allowed to enter into the territory of the Republic of Albania until _____

6. Bazuar në neni 108 të Ligjit nr. 79/2021 "Për të huajt", shtetasi i interesuar mund të kërkojë vetëm rishikim administrativ të këtij urdhri pranë autoritetit lëshues
Based on the article 108 of Law no. 79/2021 "On Foreigners", the interested citizen may ask the administrative review of the this order at the issuing authority

7. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.
This Order enters into force immediately

I larguari: _____
The expelled Person
Mora njoftim Dt. _____ ora _____
I was informed On _____ at _____

DREJTORI
DIRECTOR



ANEKSI NR. 8



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
Drejtoria Përgjithshme e Policisë së Shtetit
Departamenti për Kufirin dhe Migracionin
Drejtoria Vendore e Kufirit dhe Migracionit _____

URDHËR / ORDER

Qëndrim i detyruar në një territor të caktuar
Compulsory stay within a specific territory

Nr. _____ datë _____
No. _____ date _____

URDHËROJ
I ORDER

1. Qëndrimin e detyrueshem në territor të caktuar të shtetasit:
Compulsory stay within a specific territory of citizen;

Mbiemri _____
Family name

Emri _____
First name

Emri i babait _____
Fathers Name

Emri i nënës _____
Mothers Name

Datëlindja _____
Date of birth

Vendlindja _____
Place of birth

Gjinia _____
Sex

Shtetësia _____
Nationality

Dokumenti udhëtimit Nr. _____
Travel document no

në zbatim të Ligji Nr. 79/2021 "Për të huajt", Neni 113, për arsyet në vijim;
based on Law no. 79/2021, "On Foreigners" Article 113, for the following reasons;

☐ pika 1(a); ☐ pika 1(b) ☐ pika 1(c) ☐ pika 1(ç)

2. Qëndrim i detyruar në territorin: _____
Compulsory stay within the territory

3. Kohëzgjatja e qëndrimit: nga: _____ deri: _____
The duration of stay: from: _____ to: _____

4. Bazuar në piken 4 të nenit 113, i huaji të paraqitet pranë Autoriteti Rajonal për Kufirin dhe Migracionin:
Referring to the point 4 of Article 113, the foreigner must be submitted at the Regional Authority for Border and Migration:

Cdo _____, datë _____, ora _____
Every _____, on _____, time _____

5. Kundër këtij urdhri mund të bëhet ankesë mbështetur në Nenin 113, pika 2 të Ligjit nr.79/2021 "Për të huajt".
This order may be appealed based on t point 2, Article 113 of the Law no.79/2021 "On Foreigners".

6. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.
This order enters into force immediately.

I larguari: _____
The Expelled Person

DREJTORI
DIRECTOR

Mora njoftim Dt. _____ ora _____
I was informed on _____ at _____



ANEKSI NR. 9



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
Drejtoria Përgjithshme e Policisë së Shtetit
Departamenti për Kufirin dhe Migracionin
Drejtoria Vendore e Kufirit dhe Migracionit _____

DETYRIM PËR T'U PARAQITUR
OBLIGATION TO REPORT

Nr. _____ Datë _____
No. _____ Date _____

Në mbështetje të Ligji Nr. 79/2021 “Për të huajt”, shtetasi:
Based on Law no. 79/2021, “On Aliens”, the citizen

Mbiemri
Family name

Emri
First name

Emri i babait
Father's Name

Emri i nënës
Mother's Name

Datëlindja
Date of birth

Vendlindja
Place of birth

Gjinia
Sex

Shtetësia
Citizenship

Dokumenti udhëtimit Nr.
Travel document no

Për arsyet në vijim:
For the following reasons:

- ☐ (a) Referuar Neni 110/a të Ligjit 79/2021 “Për të huajt”
Referring to the Article 110/a of the Law 79/2021 “On Aliens”
- ☐ (b) Referuar Neni 110/b të Ligjit 79/2021 “Për të huajt”
Referring to the Article 110/b of the Law 79/2021 “On Aliens”
- ☐ (c) Referuar Neni 110/c të Ligjit 79/2021 “Për të huajt”
Referring to the Article 110/c of the Law 79/2021 “On Aliens”

1. Detyrohet të paraqitet në datat e caktuara në tabelë pranë _____
Is obliged to report on certain dates in table at:

Data / Date	Ora / Time	Nënshkrimi i Zyrtarit / Officer's Signature

2. Kjo masë mbetet në fuqi deri kur shtetasi të largohet nga territori.
The obligation to report shall be in force until the alien leaves the territory.

I larguari/ i dëbuar : _____
The removed /expelled Person

DREJTORI
DIRECTOR

Mora njoftim Dt. _____ ora _____
I was informed on at



ANEKSI NR. 10



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË
Departamenti për Kufirin dhe Migracionin
Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin _____

Nr. _____ Prot. _____, më, __. __. ____

DOKUMENT IDENTIFIKIMI

(Për zëvendësimin e dokumentit të udhëtimit)

IDENTIFICATION DOCUMENT

For replacement travel document

EMRI _____ ATËSIA _____ MBIEMRI _____
First name Father name, Family name

Vendlindja _____ Datëlindja _____
Place of birth Date of birth

SHTETËSIA _____ GJINIA _____ GJENDJA CIVILE _____
Nationality Sex Marital Status

Ky dokument është i vlefshëm deri më datë _____
This Residence Permit is valid until _____

DREJTORI
DIRECTOR



ANEKSI NR. 11



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSSHME
Drejtoria Përgjithshme e Policisë së Shtetit
Departamenti për Kufirin dhe Migracionin
Drejtoria Vendore e Kufirit dhe Migracionit _____

Urdhër për ndalimin në Qendrën e Mbyllur
Order for detention in a closed centre

Nr. _____ Datë _____
No. _____ Date _____

Bazuar në Ligjin Nr. 79/2021 “Për të huajt”, Neni 115 ;
Based on Law no. 79/2021 “On Aliens”, Article 115;

URDHËROJ
I ORDER

1. Ndalimin në Qendrën e Mbyllur të shtetasit:
The detaining at the Closed Center of the citizen as follows;

Mbiemri <i>Family name</i>	Emri <i>First name</i>		
Emri i Babait <i>Fathers Name</i>	Emri i Nënës <i>Mothers Name</i>		
Datëlindja <i>Date of birth</i>	Vendlindja <i>Place of birth</i>		Gjinia <i>Sex</i>
Shtetësia <i>Nationality</i>	Dokumenti i udhëtimit Nr. <i>Travel document no</i>		

për arsyet në vijim;
for the following reasons;

- ☐ (a) Është subjekt i një urdhri dëbimi;
She/he is subject of an expulsion order;
- ☐ (b) Për arsye të sigurisë publike (identiteti apo arsyet e qëndrimit të të huajt nuk janë të qarta).
For public security reasons, (whose identity or purpose of stay is unclear).

2. Kundër këtij urdhri mund të bëhet ankesë mbështetur në nenin 116, të Ligjit nr.79/2021“Për të huajt”; “
This order may be appealed based on Law no.79/2021 “On Aliens” Article 116;

3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.
This Order enters into force immediately

Indaluari: _____
Detained Person

DREJTORI
DIRECTOR

Mora njoftim Datë. _____ ora _____
I was informed on date _____ at _____

**URDHËR****Nr. 281, datë 13.9.2022****PËR DELEGIM TË PËRKOHSHËM TË
KOMPETENCAVE**

Në zbatim të nenit 28 dhe 29, të Kodit të Procedurave Administrative; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 58, datë 29.1.2004, “Për organizimin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar”; të nenit 26 të rregullores së brendshme të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 1, datë 14.1.2015, “Për miratimin e rregullores së brendshme të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e përkohshëm të kompetencave të mëposhtme të titullarit të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, me përjashtim të kompetencave të cilat nuk delegohen dhe që janë të shprehura me ligj, Drejtorit të Drejtorisë së Sigurimit, Administrimit të Dokumenteve dhe Regjistrit Qendror, z. Agron Cani.

2. Z. Agron Cani i delegohen kompetencat si më poshtë:

- ndjek dhe zbaton “Rregulloren për funksionimin dhe organizimin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar” (të ndryshuar);

- ndjek dhe monitoron prezencën në punë të personelit të DSIK-së;

- ndjek detyrat e vendosura në planin mujor;

- merr dhe trajton korrespondencën shkresore.

3. Kompetencat e mësipërme delegohen për periudhën nga data 14.9.2022 deri në datën 19.9.2022.

4. Z. Agron Cani nuk mund t’i nëndelegojë këto kompetenca.

5. Për ndjekjen e këtij urdhri ngarkohet Drejtori i Drejtorisë së Sigurimit, Administrimit të Dokumenteve dhe Regjistrit Qendror.

6. Me njohjen dhe zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjithë nëpunësit/punonjësit e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.

7. Ky urdhër hartohet në 3 (tri) kopje të njëjta, një për Protokoll/Arkivin, një për Drejtorin e Drejtorisë së Sigurimit, Administrimit të Dokumenteve dhe Regjistrit Qendror dhe një për QBZ-në.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Dorian Tola

VENDIM**Nr. 3, datë 12.9.2022****PËR ZGJEDHJEN E Z. ILIR TOSKA,
ANËTAR TË GJYKATËS KUSHTETUESE**

Mbledhja e Posaçme e Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, e përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Sadushi	zëvendëskryetar;
Artur Kalaja	anëtar;
Ilir Panda	anëtar;
Ervin Pupe	anëtar;
Sokol Binaj	anëtar;
Albana Boksi	anëtare;
Sandër Simoni	anëtar;
Asim Vokshi	anëtar;
Medi Bici	anëtar;
Arbena Ahmeti	anëtare;
Gentian Medja	anëtar;
Darjel Sina	anëtar;
Sokol Ngresi	anëtar;
Margarita Buhali	anëtare;
Enton Dhimitri	anëtar;

në mbledhjen e datës 12.9.2022, që kishte në rend të ditës zhvillimin e procedurës për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, i cili është në emërtesë të saj,

VËREN:

1. Sipas nenit 125 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Gjykata e Lartë është një nga organet që zgjedh 3 (tre) anëtarë të Gjykatës Kushtetuese.

2. Mbi bazën e njoftimit të Gjykatës Kushtetuese për krijimin e një vendi vakant, dhe që sipas formulës së përcaktuar në Kushtetutë është në emërtesën e Gjykatës së Lartë, kjo e fundit, në datën 21.2.2019, shpalli thirrjen e shprehjes së interesit për të kandiduar në këtë pozicion vakant, për pjesën e mbetur të mandatit që përfundonte në



datën 8.4.2022. Për shkak të mosplotësimit të numrit të nevojshëm të kandidaturave, thirrja është rishpallur në datën 19.4.2019 dhe në datën 3.6.2021. Me shkresën nr. 215 prot., datë 4.10.2021, Kryetari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi i është drejtuar përsëri Gjykatës së Lartë për të vlerësuar rishpalljen e thirrjes për këtë vend vakant.

3. Zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë më datë 15.11.2021, ka rishpallur thirrjen për plotësimin e vendit vakant për një mandat të plotë 9-vjeçar, që krijohet nga përfundimi i mandatit të ish-gjyqtarit Gani Dizdari në datën 8.4.2022.

4. Lista e kandidatëve që aplikuan për këtë vend vakant, së bashku me dokumentacionin shoqëruar iu përcoll Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, organ që ka në kompetencë kryerjen e verifikimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve.

5. Në datën 15.8.2022, pasi Këshilli i Emërimeve në Drejtësi përfundoi procesin e shqyrtimit të kandidaturave, i përcolli Gjykatës së Lartë listën e kandidatëve së bashku me raportin dhe dokumentacionin përkatës.

6. Me vendimin nr. 298, datë 19.8.2022, zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë vendosi thirrjen më datë 12.9.2022, të Mbledhjes së Posaçme për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese.

7. Mbi bazën e vendimit nr. 1, datë 24.2.2022, “Rregullorja e Mbledhjes së Posaçme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese”, si dhe referuar listës së kandidatëve dhe renditjes së tyre, të përcjellë nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë, me urdhrin nr. 252, datë 19.8.2022, miratoi fletën tip të votimit për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese. Fleta e votimit përmbante listën me kandidatët: Ilir Toska, Manjola Xhaxho dhe Holta Zaçaj.

8. Në datën 29.8.2022, kandidatja Manjola Xhaxho ka paraqitur dorëheqjen nga procesi i kandidimit për këtë vend vakant. Në kushtet kur zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë e kishte miratuar paraprakisht fletën e votimit, në datën 19.8.2022, dhe duke qenë se dorëheqja e kandidatës Manjola Xhaxho është paraqitur më pas, Mbledhja e Posaçme e Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë konkludoi se mbetet e pandryshuar lista me renditjen e kandidatëve të paraqitur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi.

9. Në datën 12.9.2022, u zhvillua Mbledhja e Posaçme e Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, ku morën pjesë të gjithë gjyqtarët e Gjykatës së Lartë (15 gjyqtarë), duke plotësuar numrin e mjaftueshëm për vlefshmërinë e mbledhjes dhe realizimin e procesit të zgjedhjes së anëtarit të Gjykatës Kushtetuese.

10. Referuar Rregullores së Mbledhjes së Posaçme, procesi i votimit u administrua nga komisioni i posaçëm i votimit, në përbërje të të cilit janë kancelari i Gjykatës së Lartë, kryesekretarja dhe një sekretare gjyqësore.

11. Në përfundim të procesit të votimit, komisioni i votimit, pas numërimit të fletëve të votimit, deklaroi numrin e votave të marra nga kandidatët, nga ku rezultoi se kandidati Ilir Toska mori 13 (trembëdhjetë) vota, kandidatja Holta Zaçaj mori 1 (një) votë dhe kandidatja Manjola Xhaxho mori 1 (një) votë.

12. Sipas nenit 7/ç, pika 4, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese nevojitet një shumicë prej 3/5 të gjyqtarëve të pranishëm. Në kushtet kur kandidati Ilir Toska fitoi shumicën e votave (13 nga 15 vota) të nevojshme sipas ligjit, ky kandidat konsiderohet i zgjedhur në detyrën e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE,

Në mbështetje të pikës 1, të nenit 125 të Kushtetutës dhe të nenit 7/ç, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” (të ndryshuar), bazuar në rezultatet e votimit të zhvilluar në datën 12.9.2022, për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, Mbledhja e Posaçme e Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë

VENDOSI:

1. Z. Ilir Toska zgjidhet anëtar i Gjykatës Kushtetuese me mandat të plotë 9-vjeçar.

2. Ky vendim i dërgohet Kryetarit të Kuvendit, Presidentit të Republikës dhe Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese.



3. Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare dhe në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë.

Zëvendëskryetar: Sokol Sadushi

Anëtarë: Artur Kalaja, Ilir Panda, Albana Boksi, Sokol Binaj, Ervin Pupe, Medi Bici, Asim Vokshi, Sandër Simoni, Darjel Sina, Gentian Medja, Arbena Ahmeti, Enton Dhimitri, Margarita Buhali, Sokol Ngresi

KËRKESË

Nr. 389/6, datë 14.9.2022

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësim shpall kërkesën “Për shpronësim për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor ‘Mbikalim këmbësorësh Bahçallëk’”.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim për interes publik, “Për shpronësim për interes publik

të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor ‘Mbikalim këmbësorësh Bahçallëk’”.

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këtë listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Autoritetin Rrugor Shqiptar, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit 2,978,850 (dy milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË
POSAÇËM TË SHPRONËSIMEVE
Egra Ibrahim

LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PRONARËVE PASURITË E PALUAJTSHME,
PRONË PRIVATE, TË TË CILËVE PREKET NGA NDËRTIMET I PROJEKTIT “MBIKALIM KËMBËSORËSH BAHÇALLËK”

		Pronari			Sip.	Tokë “truall”			Vlera		
Nr.	Emri	Mbiemri	Nr. i pas.	ZK	Totale	Sipërfaqja e shpronësuar (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera (lekë)	Totale	Shënime	Adresa e pronarit
1	Esat	Malevija	17/638	8591	350	350	8511	2978850	2978850	Konfirmime nga ASHK-ja	Bashkia Shkodër RR/1 Bahçallëk
	Hava										
	Daut										
	Rifat										
	Hajrullah										
	Shuaip	Jula									
	halid										
	Ermira										
	Bardhyl										
	Satbere										
	Qemal	Bashli									
	Suzana										
	Nezihate										
	Agron										
	Halit										
	Linje										
	Valbona										
	Bajram										
	Milhat										
	Nazmi										
Ermira	Bashli(Kadija)										
Zamir	Bashli (Hoxha)										
Saime	Bashli(Salko)										
Ylvet											
Dumije											
Ali											
Zija											
TOTALI		Demi						2978850	2978850		

KËRKESË

Shtetasi Bujar Bardhi kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë shpalljen e vdekjes së vëllait të tij, shtetasit Mentor Bardhi, në datën 15.4.1997, në fshatin Rusan, Bashkia Delvinë.

KËRKUES
Bujar Bardhi

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 192 lekë